FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 109

Tiranë – E martë, 9 qershor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 61/2020 datë 14.5.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.....	6149
Dekret i Presidentit nr. 11506, datë 8.6.2020	Për shpallje ligji.....	6151
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 27.5.2020	Për një shtesë në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar.....	6151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 3.6.2020	Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale *Broadband* 2020–2025.....	6151
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 89, datë 22.5.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 22.4.2020, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Niçë', me kapacitet të instaluar 2270"'	6190
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 90, datë 22.5.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë "*Wenerg*" sh.a., për barrësim të aseteve të luajtshme (makineri dhe pajisje), në favor të bankës "OTP Albania" sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura, me qëllim financimin e ndërtimit të HEC "Dardha 1"	6194

LIGJ
Nr. 61/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 43/2015, "PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 91 shtohen pikat 92 dhe 93 me këtë përmbajtje:

"92. "Zyrtari i pajtueshmërisë" është një person fizik ose juridik, i pavarur, i përcaktuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i ngarkuar me monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e programit të pajtueshmërisë.

93. "Kabinë elektrike" është tërësia e mjeteve themelore dhe pajisjeve elektrike të lidhura në tensionin e mesëm dhe të ulët me rrjetin e shpërndarjes, funksioni i të cilave është të kontrollojnë lidhjen, të transformojnë, të transmetojnë dhe të matin energjinë elektrike që furnizohet ose prodhohet për lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese të klientëve ose prodhuesve për këto nivele tensioni.".

Neni 2

Në nenin 17, fjalia e dytë e pikës 4 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 28, fjalia e parë dhe e dytë e pikës 5, si dhe pika 7 shfuqizohen.

Neni 4

Në nenin 31, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Linjat e reja të interkoneksionit, që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.".

Neni 5

Në nenin 49, pika 2, pas shkronjës "h" shtohet shkronja "i" me këtë përmbajtje:

"i) zhvillimin e procesit konkurrues për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë nga hidrocentralet.".

Neni 6

Në nenin 60, pika 8 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 69, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje:

"b/1)bën mirëmbajtjen dhe riparimin periodik ose sipas nevojës së rastit të kabinave elektrike, të cilat janë në bashkëpronësi, apo në pronësi të të tretëve. Përjashtimisht janë përgjegjës vetë për mirëmbajtjen dhe riparimin e kabinave elektrike, klientët jofamiljarë privatë që shprehin vullnetin për kryerjen vetë të mirëmbajtjes dhe riparimit, si dhe kur kabina elektrike është me një përdorues.".

Neni 8

Pas nenit 71 shtohet neni 71/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 71/1

1. Kushtet teknike për ndërtimin dhe instalimin e pajisjeve në kabinat e reja elektrike, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet që i ndërtojnë ato përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, të cilat harmonizohen me rregullat dhe kushtet teknike ndërkombëtare. Këto kushte zbatohen për të gjitha kabinat elektrike në rast se riparimi ose modifikimi i tyre kalon mbi 25 % të volumit material dhe inventarit të kabinës, si edhe kur vlera

e riparimit është më e lartë se 30 % të totalit të vlerës së kontabilizuar në momentin fillestar të regjistrimit të saj.

2. Vlerësimi i konformitetit të ndërtimit të kabinave elektrike kryhet nga organe të miratuara për këtë qëllim nga ministri. Rregullat dhe procedurat për miratimin e këtyre organeve miratohen me udhëzim të ministrit.

3. Shpenzimet për ndërtimin e kabinave të reja nga subjekte juridike dhe persona fizikë tregtarë mbulohen nga vetë bashkëpronarët.

4. Pronësia e kabinës elektrike është e përdoruesit, deri në amortizim të plotë të vlerës së asetit apo kur përdoruesi kalon pronësinë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet palëve. Pas amortizimit të plotë të vlerës së asetit, pronësia e kabinës kalon tek Operatorit i Sistemit të Shpërndarjes. Metodologjia e amortizimit të plotë të vlerës së kabinës elektrike propozohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe miratohet me vendim të Entit Rregullator të Energjisë, bazuar në ligjin për kontabilitetin dhe standardet ligjore në fuqi për vlerësimin e aseteve dhe të pasurisë.

5. Çmimi i punimeve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së kabinave elektrike përditësohet në mënyrë periodike në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 9

Në nenin 72, pika 3, shkronjat "a" dhe "b" ndryshohen si më poshtë:

"a) të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar e energjisë elektrike, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.

Për të përmbushur këto detyra, operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, përfshirë burimet njerëzore, teknike, fizike dhe financiare.

Shoqëria mëmë (kontrolluese) ka të drejtën e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale, në lidhje me kthimin e aktiveve, miratimin e planit ekonomik financiar ose çdo instrument tjetër të barasvlershëm të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të vendosë kufijtë e përgjithshëm në nivelet e borxhit të shoqërisë bijë (të kontrolluar).

Shoqëria mëmë (kontrolluese) nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operacionale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë dhe nuk ka të drejtë të marrë vendime lidhur me ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit të të cilave nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë apo legjislacionin në fuqi;

b) të hartojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objektivi.

Personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë (zyrtari i pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) paraqet çdo vit në ERE një raport vjetor, i cili përcakton masat e marra në kuadër të programit të pajtueshmërisë. Ky raport publikohet në faqen zyrtare të ERE-s.

Zyrtari i pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka akses në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo shoqërie të lidhur, për të përmbushur detyrën e tij.".

Neni 10
Dispozitë kalimtare

Parashikimi i nenit 4, të këtij ligji, nuk zbatohet për subjektet që janë pajisur me "Miratim paraprak të ndërtimit të kapaciteteve të reja të energjisë", në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 dhe 8 të tij.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.5.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11506, datë 8.6.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11506, datë 8.6.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 61/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015 'Për sektorin e energjisë elektrike'", të ndryshuar.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr. 24, datë 27.5.2020

PËR NJË SHTESË NË AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas pikës 21, të nenit 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 22, me këtë përmbajtje:

"22. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari turistike në stacionet e plazhit dhe që nuk respektojnë rregullat dhe protokollet e sigurisë, të nxjerra nga organet kompetente, dënohen me gjobë 700 000 (shtatëqind mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje, iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë nga inspektoratet përgjegjëse.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 434, datë 3.6.2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË INFRASTRUKTURËS DIGJITALE *BROADBAND* 2020–2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të infrastrukturës Digjitale *Broadband* 2020–2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.Vendimi nr. 468, datë 30.5.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit Kombëtar të *Broadbandit*", i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet ministri i infrastrukturës dhe Energjisë që të bashkëpunojë me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe institucionet e tjera, të përcaktuara në plan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË INFRASTRUKTURËS DIGJITALE *BROADBAND* 2020–2025

PASQYRA E LËNDËS

Lista e shkurtimeve
Prezantimi dhe qëllimi i dokumentit
Rëndësia e infrastrukturës *Broadband*
Çfarë është *Broadband*?
Analiza e situatës aktuale
Gjendja në tregun e telekomunikacioneve
Vështrim i përgjithshëm
Tregu *Broadband*
Kërkesa për *Broadband*
Ndarja digjitale
Realizimi i objektivave dhe qëllimeve sipas planit kombëtar të *Broadband* 2013
Problematika të sektorit dhe sfida të zhvillimit *Broadband*
Ndarja digjitale dhe nevoja e financimit
Rregullimi i aksesit dhe përdorimi i përbashkët i infrastrukturës
Menaxhimi i spektrit
Konkurrenca e ndershme
Masat për përmbushjen e objektivave dhe prioriteteve
Përmirësimi i atlasit *Broadband*
Përmirësimi i klimës së investimeve
Bashkëpërdorimi infrastrukturës ekzistuese
Cilësia e shërbimit dhe mbrojtja a konsumatorit
Strategjia dhe implementimi i 5G
Rrjetet *wifi* për publikun
Adresimi i sigurisë së rrjeteve *Broadband*
Forcimi i kuadrit institucional për zhvillimin *Broadband*
Rritja e kërkesës – përdorimi i infrastrukturës nga
Zhvillimi i qëndrueshëm i rrjeteve *Broadband* dhe ekonomia e gjelbër
Zgjerimi i burimeve financiare dhe fondeve për zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*
Rishikimi i shërbimit universal dhe skemat e financimit
Menaxhimi i spektrit
Konkurrenca e ndershme e qëndrueshme
Zhvillimet inovatore për ekonominë digjitale
Modelet e financimit për implementim
Mekanizmat e implementimit dhe monitorimi
Kostot e implementimit
Shtojcat

LISTA E SHKURTIMEVE

AI	Inteligjenca Artificiale
AKCES	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
ATLAS	Regjistër Elektronik i quajtur "Atlasi Elektronik i AKEP"
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
B2B	Biznes – Biznes
BBCom	Komisioni *Broadband* për Zhvillim të Qëndrueshëm
BE	Bashkimi Evropian
BPL	*Broadband* në linjat elektrike
BTS	Stacione Bazë të Transmetimit
CIRT	Skuadra Përgjegjëse ndaj Incidenteve Kibernetike
DD2	Dividenti Digjital 2
DSL	Linja Digjitale e Abonentit
EGDI	Indeksi i Zhvillimit të E-Government
ESIF	Fondet Evropiane Strukturore dhe Investuese
FTTB	Fibër në Ndërtesë
FTTC	Fibër në Kabinet
FTTH	Fibër në Shtëpi
FTTN	Fibër në Nyje
FTTx	Fibër në X
GMIP	Grupet e Menaxhimit të Integruar të Programeve
GNI	Të Ardhurat Bruto Kombëtare
GSR	Simpoziumi Global për Rregullatorët
HFC	Linjë Hibride Fibër - Koaks
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman (Përqendrimi i Tregut)
HPC	Kompjuter me Performancë të Lartë
HSPA/+	Akses i Paketave me Shpejtësi të Lartë/+
IDI	Indeksi i Zhvillimit të TIK
INSTAT	Instituti i Statistikave
IoT	Interneti i Gjërave
ISP	Ofrues i Shërbimit Internet
ITU	Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve
KDS	Komitetet Drejtuese Sektoriale
LLU	Akses i Hapur në Rrjetin Lokal
LTE	Standard për Komunikimet Mobile (*Long Term Evolution*)
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MNO	Operator i Rrjetit të Lëvizshëm
MPLS	Multiprotocol Label Switching – teknikë që përshpejton kalimin e të dhënave
MT	Tarifat e Terminimit Mobile
NGA	Aksesi i Gjeneratës Tjetër
NGN	Rrjete të Gjeneratës Tjetër
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OECD	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
RoW	E Drejta e Kalimit
SHU	Shërbimi Universal
SME	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
SMP	Fuqia e Ndjeshme e Tregut
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TSO	Operatorët e Shërbimeve Transit
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
USF	Fondi i Shërbimit Universal
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VoIP	Telefonia në internet (Voice over IP)
WBIF	Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor
WEF	Forumi Ekonomik Botëror
WIFI	Internet Pa Tel
WiFi4EU	WiFi për Bashkimin Evropian
WSIS	Samiti Botëror për Shoqërinë e Informacionit
3G	Gjenerata e Tretë e Rrjeteve të Telefonisë së Lëvizshme
4G	Gjenerata e Katërt e Rrjeteve të Telefonisë së Lëvizshme
4IR	Revolucioni i Katërt Industrial
5G	Gjenerata e Pestë e Rrjeteve të Telefonisë së Lëvizshme

Prezantimi dhe qëllimi i dokumentit

Zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), është ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe pjesë e objektivave strategjikë kombëtarë, për zhvillimin dhe integrimin.

Qeveria e Shqipërisë, duke kuptuar rolin që TIK dhe transformimi digjital, mund të luajnë në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social të vendit, ka identifikuar disponueshmërinë e një game të gjerë shërbimesh të komunikimit dhe *Broadband*-in si përparësi kryesore, në dokumentet strategjike për zhvillimin e TIK, në Agjendën Digjitale, Programin e Reformave Ekonomike.

Qeveria Shqiptare, ka pranuar gjithashtu, që për të shfrytëzuar fuqitë transformuese të TIK-ut, është thelbësore që të ketë një infrastrukturë *Broadband* të shpejtësisë së lartë, në të gjithë vendin. Zhvillimi i infrastrukturës *Broadband*, është pjesë e projekteve kombëtare me rëndësi strategjike. Me mbështetjen e Komisionit të Kombeve të Bashkuara, për Zhvillim të Qëndrueshëm të *Broadband* ("BBCom"), në vitin 2013, u miratua Plani i Parë Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband*, i cili siguroi një vizion, objektivat e përgjithshëm përkatës dhe qëllimet specifike, për t'u arritur gjatë periudhës 2013–2020. Plani ishte reflektim i synimeve të "BBCom" për vitin 2020 dhe u modelua mbi objektivat e BE-së për *Broadband* për vitin 2020, duke përfshirë po pa u kufizuar në një fokusim mbi zgjerimin e infrastrukturës edhe në zonat rurale dhe të largëta, dyfishimin e lidhjeve në familje dhe biznese deri në fund të vitit 2017, realizimin e lidhjeve 100% të shkollave, universiteteve, zyrave postare, qendrave shëndetësore, spitaleve, si dhe zgjerimin e numrit të shërbimeve elektronike për qytetarët shqiptarë dhe digjitalizimin e të gjitha shërbimeve publike.

Që nga miratimi i këtij dokumenti, Shqipëria ka bërë progres, në përgatitjen dhe nxitjen e transformimit digjital të ekonomisë së saj, si dhe organizmin institucional dhe administrativ, duke përcaktuar kështu ambicien e saj në "Strategjinë Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015–2020", në përputhje me Rezolutën 71 të miratuar në Konferencën e të Plotfuqishmëve të ITU-së, Dubai 2018. Aspirata e Shqipërisë, është të arrijë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, gjë që kërkon përafrimin dhe zbatimin e Acquis Communautaire, në të gjitha fushat e ekonomisë dhe shoqërisë, mundësuar përmes konvergjencës së niveleve ekonomike, institucionale dhe administrative të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Raporti i fundit i BE-së për Shqipërinë i vitit 2019, nënvizon se Shqipëria është përgatitur në mënyrë të moderuar, në fushën e shoqërisë së informacionit dhe mediave audiovizive. Progres është bërë, lidhur me implementimin e Agjendës Digjitale të Shqipërisë, Planin Kombëtar të *Broadband*-it dhe të shërbimeve të *e-government*. Fakti, që Shqipëria është në një rrugë të mirë zhvillimi, me mbi 75% të popullsisë përdorues të internetit, me më shumë se 95% të ndërmarrjeve që kanë akses në internet, gjë e cila është dhe mbi mesataren e BE-së, mbështetet dhe nga statistikat kryesore të gjetjeve të raporteve. Për më tepër, në fushën e shërbimeve të e-government, e cila është një nga kërkesat më të rëndësishme të Samitit Botëror për Shoqërinë e Informacionit (WSIS), Shqipëria ka ecur shumë përpara me zhvillimin e shërbimeve elektronike. Krijimi i portalit qeveritar e-albania.al, ka sjellë më shumë se 600 shërbime elektronike në funksion të qytetarëve, bizneseve dhe punonjësve të administratës, dhe më shumë se 1,300,000 përdorues të regjistruar.

Në "Indeksin e Zhvillimit të *E-Government*" ("EGDI"), të Kombeve të Bashkuara për vitin 2018, Shqipëria shënoi rezultatin më të lartë mes vendeve të rajonit, në lidhje me shërbimet *online*, si dhe një rezultat të mirë për sa i përket kapitalit njerëzor. Për më tepër Raporti i Diagnostifikimit Digjital, i përgatitur në kuadër të Studimit të Fizibilitetit WBIF19, thekson se shërbimet e-Government, u janë mundësuar pothuajse të gjitha bashkive. Kjo ka ardhur si pasojë e një niveli të kënaqshëm të aftësive për TIK dhe për përdorimin e tij. Indeksi i ITU-së i vitit 2017,, për zhvillimin e TIK ("IDI"), e rendit Shqipërinë, mbi nivelin mesatar të nënindekseve IDI, në lidhje me aftësitë dhe përdorimin.

Megjithatë, në ditët e sotme, pika më e dobët e Shqipërisë është infrastruktura e TIK, në veçanti infrastruktura *Broadband* (me shpejtësi të lartë), si në lidhje me disponueshmërinë, ashtu edhe me cilësinë (shpejtësinë). Në nënindeksin e IDI për akses në IDI, Shqipëria është renditur nën mesataren botërore, kryesisht për shkak të rrjeteve fikse. Ky pozicion relativisht i dobët, në lidhje me infrastrukturën, është pasqyruar në EGDI 2018, të Kombeve të Bashkuara, ku Shqipëria renditet

dobët në komponentin e infrastrukturës së Telekomunikacionit. Megjithëse ka një përparim, në lidhje me objektivat e Planit Kombëtar të Zhvillimit të *Broadband* 2013, për sa i përket infrastrukturës, qëllimet e caktuara në të nuk janë arritur plotësisht. Një ndarje e konsiderueshme (*digital gap*), midis zonave rurale-urbane vazhdon, kjo kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme për të siguruar lidhjen në këto zona.

Objektivi i këtij dokumenti, është përditësimi i Dokumentit të Politikave për *Broadband*. Në Raportin më të fundit të BE-së 2019 për Shqipërinë, është rekomanduar, rishikimi i Planit Kombëtar të *Broadband* i vitit 2013, me objektiva dhe qëllime më të qarta, në kontekstin e zhvillimeve më të fundit të tregut, si dhe të kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional që nga viti 2013.

Për këtë qëllim, më 5 korrik 2019, në ambientet e MIE, u mbajt një konsultim shumëpalësh, përfshirë këtu një tavolinë të rrumbullakët me aktorët e ndryshëm, si dhe një pyetësor dërguar këtyre të fundit. Qëllimi ishte diskutimi për pikëpamjet dhe perspektivën nga të gjithë pjesëmarrësit, në lidhje me vizionin aktual dhe të ardhshëm të Planit Kombëtar për *Broadband*, objektivave të përgjithshëm të tij, si dhe qëllimet specifike. Gjithashtu, aktorëve ju kërkua të ndanin sfidat kryesore dhe prioritetet në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës *Broadband* për periudhën 2020–2025.

Ndërsa vizioni dhe shumica e objektivave të përgjithshëm dhe qëllimeve aktuale të Planit Kombëtar të Zhvillimit të *Broadband*-it për vitin 2013, rezultuan të jenë ende koherente, analiza e përgjithshme, nxori në pah se duke pasur parasysh ndarjen digjitale të vazhdueshme, fokusi i Planit të zhvendosej drejt zgjerimit të infrastrukturës *Broadband* me shpejtësi të lartë me kosto sa më efektive, për të mbuluar të gjithë vendin, dhe në veçanti për të zhvendosur më shumë vëmendjen në mbulimin e zonave rurale dhe të largëta, pa lënë jashtë vëmendjes zhvillimin e infrastrukturës *Broadband* në zonat urbane.

Fokusi nevojitet të jetë tek identifikimi dhe futja e mekanizmave të rinj të financimit, në një bazë më të gjerë palësh të interesuara, duke përfshirë angazhimin e shtuar financiar nga sektori publik. Kjo zhvendosje e përqendrimit, mbështetet fuqimisht dhe nga gjetjet e Studimit të Fizibilitetit për zhvillimin e Broadbanit Rajonal në Raportin e Diagnostifikimit Digjital të WBIF19, i cili jep njohuri kryesore për situatën në zonat rurale dhe të largëta dhe thekson mungesën e stimujve nga operatorët e rrjetit për të investuar në këto zona. Kjo situatë është gjithashtu në përputhje me strategjinë e Komisionit Evropian "Konektiviteti për një Shoqëri Evropiane Gigabit" dhe nismat e saj plotësuese, veçanërisht në lidhje me rregullat e reja të Ndihmës Shtetërore. Për rrjedhojë, objektivat e përgjithshëm aktualë dhe qëllimet specifike për zhvillimin e *Broadband*, janë rishikuar duke formuluar objektiva dhe qëllime të reja, të cilat reflektojnë më shumë nevojat e tregut vendas për të ecur përpara, me një fokus të theksuar në zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*, duke përfshirë këtu identifikimin e masave më të efektshme për financim, si dhe të aktiviteteve për zbatim.

Vlen të theksohet, se dokumenti do të plotësohet me rezultatet e Studimit të Fizibilitetit të WBIF, i cili do të përfundojë gjatë pjesës së parë të vitit 2020. Studimi i Fizibilitetit të WBIF, do të japë propozime të hollësishme mbi kërkesat për ndërtimin e infrastrukturës lokale, teknologjinë e propozuar dhe nevojat për investime, kosto dhe financim, si dhe modele të përshtatshme, për zona të ndryshme, në të gjithë vendin.

Ky dokument, është përgatitur me mbështetjen e ekspertëve të ITU-së dhe ka marrë në konsideratë dhe gjetjet e Studimit të Fizibilitetit për zhvillimin e *Broadband* (WBIF2019). Dokumenti është i strukturuar në disa seksione si vijon:

- Seksioni 1, paraqet arsyetimin për rëndësinë e infrastrukturës *Broadband*, si parakusht dhe nxitës i transformimit digjital dhe zhvillimit ekonomik dhe social-ekonomik;

- Seksioni 2, ofron një përmbledhje të situatës në tregun e *Broadband*-it, duke përfshirë një përmbledhje të progresit të bërë me synimet aktuale të Planit Kombëtar të *Broadband*;

- Seksioni 3, detajon gjetjet dhe çështjet kryesore për t'u adresuar si rezultate thelbësore, të konsultimeve me palët e interesuara;

- Seksioni 4, jep Vizionin, objektivat dhe qëllimet e propozuara dhe të rishikuara të Planit, të synuara për periudhën 2020–2025;

- Seksioni 5, prezanton politikat dhe masat që do të ndërmerren, për realizimin e objektivave dhe adresimin e prioriteteve thelbësore, për periudhën

2020–2025, si dhe përcaktimin e aktiviteteve që duhen ndërmarrë, për të çuar më tej prioritetet e identifikuara;

- Seksioni 6, prezanton modelet e mundshme të financimit për zbatimin e planit (duke reflektuar një qasje më të përgjithshme);

- Seksioni 7, përshkruan mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit;

- Seksioni 8, përcakton kostot e mundshme të implementimit të Planit (referuar studimit të WBIF).

RËNDËSIA E INFRASTRUKTURËS *BROADBAND*

Raporti më i fundit i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për *Broadband*, "State of *Broadband* Report 2019"[1], thekson se roli i *Broadband*-it, dhe përfitimet e lidhjes *Broadband*, në nxitjen e progresit të një vendi, kurrë nuk kanë qenë më të mëdha, më të qarta dhe të matshme, se sa në erën e sotme digjitale. Ashtu si dhe kanë vlerësuar studime të shumta, si dokumente të Komisionit *Broadband*, nga një studim i fundit i ITU "*Broadband* dhe Transformimi Digjital", *Broadband*-i fiks dhe i lëvizshëm, ka kontribut në rritjen e ekonomisë së një vendi, transformimin digjital dhe ndërveprimin e rregullave TIK në ekonomitë kombëtare. Studimet tregojnë se një rritje prej 1% në penetrimin e *Broadband*-it fiks, sjell një rritje prej 0.08% në PBB dhe një rritje prej 1% në penetrimin e *Broadband*-it të lëvizshëm, sjell një rritje prej 0.15% në PBB.

Çfarë është *Broadband*?

Përkufizimi i *Broadband*-it në të gjithë vendet vazhdon të zhvillohet, teksa teknologjitë përmirësohen shfaqen gjenerata të reja të teknologjisë me tel dhe pa tel, duke bërë që pritshmëritë për cilësinë, ato që përbëjnë shpejtësinë minimale të shkarkimit për përvojën optimale të përdoruesit fundor, të rriten. Rrjetet *Broadband*,janë rrjete të telekomunikacionit, apo rrjetet e komunikimeve elektronike, që mundësojnë komunikimin e të dhënave me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë.

Megjithatë, si dhe është përcaktuar nga Komisioni Evropian, termi "*Broadband*" nuk i referohet një teknologjie të veçantë që përdoret për akses në internet, por përfaqëson një term për infrastrukturë digjitale, që lejon akses në internet të shpejtë që është gjithmonë në linjë, si dhe është më i shpejtë sesa aksesi tradicional në dial-up. Komisioni përcakton tre kategori të shpejtësisë së download si më poshtë:

- "*Broadband* bazë" për shpejtësi ndërmjet 144 Kbps dhe 30 Mbps;

- "*Broadband* i shpjetë" për shpejtësi ndërmjet 30 dhe 100 Mbps; dhe

- "*Broadband* ultra i shpejtë" për shpejtësi më të larta se 100 Mbps.

- Strategjia e Komisionit Evropian "Konektiviteti për një Shoqëri Evropiane Gigabit", vendos objektivin për shpejtësi prej 1 gigabits.

Një rrjet *Broadband*, zakonisht përbëhet nga tre elementë kryesorë, duke përfshirë këtu Backbone ose Core Network, Middle Mile dhe Last Mile. Banka Botërore gjithashtu ka identifikuar një "Invisible Mile"[2], e cila përfshin përbërësit e rrjetit që nuk janë të dukshëm, përfshirë spektrin radio, databazat e rrjetit (p.sh., për numeracionin), sigurinë kibernetike dhe kështu me radhë, por gjithashtu mund të përfshijë edhe pengesa potenciale, si përqendrimi i rrjetit, taksimi i shumëfishtë i aktiviteteve, mungesa e aksesit në të drejtën e kalimit dhe rregullime joeficiente që përfshijnë çështjet rregullatore ose ndërkufitare.



Burimi: Raporti Special nr. 12: Broadband në shtetet anëtare të BE-së: përveç progresit, jo të gjitha synimet e "Europa 2020" do të arrihen, European Court of Auditors[3]

[1] https://www.itu.int/dms_pub/itu-s/opb/pol/S-POL-*BROADBAND*.20-2019-PDF-E.pdf

[2] Shiko: UN *Broadband* Commission Working Group Report 2019 "Connecting Africa Through *Broadband*: A strategy for doubling connectivity by 2021 and reaching universal access by 2030"

[3] Shiko: https://www.eurosai.org/en/databases/audits/*Broadband*-in-the-EU-Member-States-despite-progress-not-all-the-Europe-2020-targets-will-be-met/

Rrjetet *Broadband*, po bëhen pjesë integrale gjithnjë e në rritje e ekonomisë. OECD, në raportin e vet final në Vitin 2015, "Adresimi i Sfidës së Taksave në Ekonominë Digjitale", shprehet se pikërisht kjo ekonomi digjitale nuk ka më kufizime. Rrjetet *Broadband* janë baza që mund të lehtësojë zhvillimin e sfidave të reja, mallrave dhe shërbimeve të reja e të përmirësuara, proceseve të reja, modeleve të reja të biznesit, dhe që sjell rritje në konkurrueshmërinë dhe fleksibilitetin në ekonomi. Në mënyrë të përgjithshme, rrjetet *Broadband* dhe lidhjet *Broadband*, mund të mundësojnë shkallëzimin dhe performancën e TIK (dhe teknologjive 4IR), të cilat konsiderohen të jenë teknologji me qëllime të përgjithshme ("GPT"), që ndryshojnë rrënjësisht, në varësi të faktit se si dhe se ku organizohet aktiviteti ekonomik.

Broadband-i lehtëson zhvillimin e shpikjeve të reja, zgjidhjeve inovatore, të shërbimeve dhe mallrave të reja dhe të përmirësuara, proceseve të reja, modeleve të reja të biznesit, dhe rrit nivelin e konkurrueshmërisë dhe fleksibilitetit në ekonomi. Në mënyrë më të përgjithshme, *Broadband*-i ofron performancë të përmirësuar të TIK-ut, që konsiderohet të jetë një teknologji shumëqëllimëshe, e cila në mënyrë rrënjësore ndryshon mënyrën se si dhe se ku organizohet aktiviteti ekonomik.

Teksa teknologjia zhvillohet dhe gjerësia e brezit rritet, qëllimi i *Broadband*-it për të vepruar si një mundësues i ndryshimeve strukturore në ekonomishtohet, pasi prek një numër gjithnjë në rritje të sektorëve dhe aktiviteteve. Gjithashtu, *Broadband*-i njihet si një aftësues ndërsektorial, duke mbështetur përpjekjet kombëtare për zhvillimin e ekonomive të dijes, nxitjen e transformimit digjital në shërbimet qeveritare dhe tranzicionin digjital nëpër të gjithë sektorët, zgjerimin e mundësive të reja për ndërmarrjet dhe sigurimin e një vlere më të madhe për qytetarët dhe konsumatorët. Kjo është evidente në përpjekjet e ekonomive, për të lidhur *Broadband*-in me iniciativat sektoriale, përfshirë ofrimin e arsimit cilësor, promovimin e përfshirjes sociale dhe përfitimet posaçërisht në zonat rurale dhe të largëta. Efekte direkte rezultojnë nga investimet në teknologji dhe nga ndërtimi i infrastrukturës. Efekte indirekte vijnë nga ndikimi i *Broadband*-it mbi faktorët që sjellin rritje, si inovacioni, konkurrenca dhe globalizimi.

Nga zhvillimi i *Broadband*-it priten ndikime të konsiderueshme në ekonomi, duke bërë të mundur ndryshimin organizativ dhe forcimin e koordinimit, për të nxjerrë fitime nga investimet e përgjithshme në TIK. Për më tepër, krahasuar me teknologjitë e tjera shumëqëllimëshme historike, si hekurudhat dhe elektriciteti, impakti i *Broadband*-it dhe TIK-ut mund të jetë më i madh dhe të materializohet më shpejt, sipas shkallës dhe efekteve të rrjetit.

Lidhja me internet me shpejtësi të lartë dhe të kudondodhur, mundëson ekosistemet digjitale që janë komponentë të nevojshëm të programeve që synojnë zhvillim, transformimin ekonomik dhe rritjen e të ardhurave. Pra, është guri themelor dhe parakushti për transformimin digjital të ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare dhe për këtë arsye mund të konsiderohet si mjet thelbësor, krahas shërbimeve dhe infrastrukturave të tjera si rrugët, uji, elektriciteti dhe gazi.

ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

Shqipëria ka ndërmarrë një numër reformash strukturore në sektorë dhe aktivitete të ndryshme ekonomike duke përfshirë (mes të tjerave) dhe sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Qeveria Shqiptare prej më shumë se dhjetë vitesh nga strategjia e parë për zhvillimin e TIK, ka vazhduar promovimin e TIK, në sektorë të ndryshëm, duke prezantuar dhe implementuar strategji dhe politika të ndryshme, të cilat e kanë TIK në fokusin e tyre, zhvillimin e shoqërisë së informacionit, agjendën digjitale dhe zhvillimin e *Broadband*-it. Për më tepër në vitet e fundit qeveria shqiptare ka investuar fort në digjitalizimin e infrastrukturës publike dhe ngritjen e sistemeve dhe shërbimeve elektronike qeveritare.

TIK dhe komunikimet elektronike, luajnë një rol të rëndësishëm në Shqipëri. Kontributi total në PBB, i këtij sektori për vitin 2017 është 3%[4], ndërkohë që në Bashkimin Evropian, vlera e shtuar e sektorit TIK në vitin 2016 ishte 3.75% e PBB-së, e cila renditet pas Japonisë (5.4%), SHBA-së (5.3%) dhe Kinës (4.7%) në 2014. Tregu i komunikimeve elektronike në Shqipëri ka kontribuar respektivisht me 2.45% në PBB.

Gjendja në tregun e telekomunikacioneve

Vështrim i përgjithshëm

[4] Shiko: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/ICT_sector_-_value_added,_employment_and_R%26D

Tregu shqiptar i telekomunikacionit i është nënshtruar zhvillimeve të rëndësishme gjatë viteve të fundit dhe ka qenë një treg komplet i hapur për konkurrencën që nga viti 2008, me miratimin e ligjit nr. 9918, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Kompanitë kryesore që operojnë janë: Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom. Të ardhurat totale të tregut në vitin 2018 ishin 320.6 milionë USD. Të ardhurat kanë qenë të qëndrueshme për periudhën 2014–2016 dhe u pakësuan me 13% në vitin 2017 në 326.6 milionë USD. Me kalimin e kohës të ardhurat ranë me më shumë se 40%, gjatë periudhës 2008–2018. Të ardhurat nga telefonia mobile dhe fikse në vitin 2018, u ndanë në 80% : 20%. Tarifat për shërbimet telefonike dhe aksesin *Broadband* në internet nga rrjetet fikse dhe të lëvizshme janë në nivele të përballueshme për familjet me një nivel mesatar të ardhurash dhe tregu mundëson tarifa të ulëta që janë gjithashtu të arsyeshme për familjet me të ardhura të pakta.

Figura 1. Të ardhurat nga rrjetet mobile dhe fiks përgjatë 2008–2018



Burimi: AKEP

Tendencat e zhvillimit të tregut të telekomunikaconit në Shqipëri, janë në përputhje me zhvillimet në rajon, me rënie në depërtimin e telefonisë fikse, kur pajtimtarët kalojnë në rrjetin celular, dhe me përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar disponueshmërinë e *Broadband*-it dhe kushtet e aksesit. Për sa i përket përdorimit TIK, 75.6% e shqiptarëve përdorin internetin, 102% janë përdorues aktivë të shërbimeve telefonike dhe mbi 50% e familjeve kanë akses në internet fiks.

Megjithatë shpejtësitë e lidhjes *Broadband*, sipas raporteve të AKEP-it dhe rezultateve të Studimit të Fizibilitetit për zhvillimin e *Broadband*-it rajonal, janë ende të ulëta: gjerësia e bandës ekzistuese në rrjetet fikse dhe celulare, është më pak se 30 mbps.

Figura 2. Statistikat kryesore të TIK



Burimi: Imme Philbek, bazuar në statistikat e ITU, AKEP, UN Population Division, WBIF

Tregu *Broadband*

Tregu *Broadband*, është një nga tregjet më vibrues, në Sektorin e Telekomunikacionit në Shqipëri, me 240 ISP të autorizuar nga AKEP dhe tre operatorë të rrjeteve celulare, që ofrojnë shërbime celulare dhe *Mobile Broadband*. *Broadband*-i aktualisht furnizohet përmes teknologjive të ndryshme fikse dhe mobile, duke përfshirë DSL, FTTH/FTTB, FTTx në kombinim me NGA. Pjesa më e madhe e linjave DSL, kombinohen me fibër optike dhe rrjete bakri (FTTN /FTTB). Vlen të përmendet fakti që operatorët e rrjeteve fikse, gjatë viteve 2018–2020, po investojnë më së shumti në rrjete fibrash optike (FTTH dhe FTTB). Rrjetet e përbëra vetëm nga fibrat optike, po shtrihen nga operatorë të vegjël edhe në zona rurale, çka përbën një tjetër risi për Shqipërinë. Për *Broadband*-in gjithashtu përdoren linja koaksiale (HFC) dhe linja elektrike (BPL). Në terma të teknologjive mobile, *Broadband*-i furnizohet nëpërmjet 3G/HSPA/HSPA+ dhe rrjeteve 4G/LTE, si dhe nëpërmjet lidhjeve satelitore.

Operatorët kryesorë të *Broadband*it fiks janë Albtelecom, me 36% të tregut, dhe ABCOM me 18%, ASC/TRING me 14%, si dhe Abissnet me 10%.[5] Pjesa e mbetur e tregut, ndahet në operatorë alternativë që ofrojnë internet *Broadband*, bazuar në rrjetet fikse. Në lidhje me infrastrukturën *Backbone* me fibër optike, janë dy kompani kryesore që operojnë, Albtelecom dhe ATU. Penetrimi i *Broadband*-it fiks si për popullsi dhe për familje, sikurse jepet në figurën e mëposhtme, në periudhën 2013–2020 është rritur më shumë se dyfish.

Megjithatë depërtimi i rrjeteve fikse *Broadband*, mbetet mjaft poshtë nivelit të mesatares së BE-së dhe niveleve të tjera të penetrimit të vendeve fqinje, megjithëse ka rritje të qëndrueshme çdo vit me 10%-15%.

[5] Pjesa e mbetur e tregut prej 22% ndahet ndërmjet operatorëve të tjerë, përfshirë Bleta sh.p.k., Digicom dhe Nisatel. Katër operatorët kryesorë ALBtelecom, Abcom, Abissnet dh e ASC / Tring kanë një peshë totale të tregut prej 78%.

Figura 3. Penetrimi në Broadband fiks për popullsi dhe familje 2013–2019



Burimi: AKEP

Në lidhje me *Broadband*-in Mobile ekzistojnë tre operatorë kryesorë, përkatësisht Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom, të cilët ofrojnë shërbime 3G dhe 4G. Shërbimet 4G u bënë publike në korrik–shtator 2015, duke përdorur bandën e frekuencës 1800MHz, dhe duke mbuluar 65% deri në 85% të popullsisë, ndërsa mbulimi i territorit mpe 4G, është më i ulët, ndërmjet 21% dhe 55.6%. Bazuar në gjetjet e Studimit të Fizibilitetit të WBIF19, mbulimi 4G, është kryesisht i përqëndruar në zonat urbane. Në total 63% e shqiptarëve përdorin *Broadband*-in Mobile.

Sipas raporteve të monitorimeve të cilësisë së shërbimit QoS, të realizuara nga AKEP-i gjatë vitit 2019, operatorët mobile, po marrin masa për shtrirjen e mbulimit me 4G edhe në zonat rurale duke u përqendruar kryesisht në ato zona ku mbulimi me 3G nuk ka qenë shumë i mirë. Periudha e investimit, sipas deklarimit të operatorëve mobile, do të shtrihet përgjatë viteve 2020-2023.

Figura 4. Mbulimi i territorit dhe popullsisë me 2G, 3G, dhe 4G në vitin 2018

	Telekom Albania	Vodafone Albania	Albtelecom		Telekom Albania	Vodafone Albania	Albtelecom
Mbulimi Territorit (%)				Mbulimi Popullësis (%)			
GSM	92.50	96.40	93.80	GSM	99.80	99.86	99.40
3G	88.00	89.00	86.80	3G	96.50	99.20	90.40
4G	55.60	35.00	21.20	4G	85.30	70.70	65.00

Burimi: AKEP

Për sa i përket shpejtësisë së aksesit/cilësisë së shërbimit, mbetet hapësirë për përmirësim. Teknologjia kryesore që përdoret për përhapjen e lidhjeve fikse të *Broadband*-it, është ende nëpërmjet DSL (55%, që përbëhet nga 46% lidhje DSL-FTTN/FTTC dhe 9% të DSL 100% linja bakri). Vetëm 23% e lidhjeve *Broadband*, shpërndahen nëpërmjet FTTH/B, 18% me kabëll (prej të cilëve 14% janë kabëll DOC SOS 3.0) dhe 4% përdorin teknologji të tjera. Në total janë 66% abonentë NGA, që janë

kryesisht FTTN/C.[6] Në lidhje me *Broadband*-in fiks, sipas shpejtësisë së shkarkimit, në vitin 2018, 62% e abonentëve kishin shpejtësinë 4–10 mbps, 24% shpejtësinë10-30 mbps (54,000 më 2017 dhe 89,000 më 2018), dhe 12% e pajtimtarëve ishin ende nën 4 mbps. Në lidhje me *Broadband*-in e shpejtë dhe ultra të shpejtë, mbi 30 mbps, megjithëse në vitin 2017abonimet u dyfishuan, përqindja totale mbetet ende e ulët, vetëm 2%.

Gjatë vitit 2019, ka një rritje të numrit të pajtimtarëve të lidhur me shpejtësi mbi 10 mbits, duke dyfishuar numrin për periudhën 2017–2019. Në dallim nga situata e vitit 2013, ku shpejtësia e lidhjes për shumicën e pajtimtarëve ishte deri në 2Mbits, në fund të vitit 2019, kemi vetëm 1% të totalit të lidhjeve me shpejtësi deri në 2Mbits. 57% e pajtimtarëve me lidhje fikse *Broadband*, janë me shpejtësi 2–10 Mbits dhe 41% e tyre me shpejtësi mbi 10 mbits. Ndërkohë kemi vetëm një numër të vogël pajtimtarësh që përdorin shpejtësi 100 mbits ose më shumë.

Nga analizat e bëra, vlerësohet se aksesi në Mobile *Broadband* është i përballueshëm ekonomikisht. Bazuar në të dhënat e raportit të ITU-së, "Measuring the Information Society Report" (nëntor 2018), në të dhënat në tabelën e mëposhtme, Shqipëria për sa i takon përballueshmërisë ekonomike renditet mirë.

Tabela 1. Renditja e Shqipërisë për indeksin e çmimeve të ICT në raportet e ITU 2015-2017

	Renditja 2015		**Renditja 2016**		**Renditja 2017**	
	% GNI	**Renditja ITU**	**% GNI**	**Renditja ITU**	**% GNI**	**Renditja ITU**
Broadband Fiks	2.57	83	2.71	86	1.63	58
Telefoni celulare	1.71	84	1.8	94	1.87	89
Mobile *Broadband* Data (Prepaid Handset)	1.18	58	1.24	85	1.28	84
Mobile *Broadband* Data (Postpaid USB)	1.18	58	1.24	72	1.29	69

Burimi: Raporti Vjetor 2018 AKEP[7]

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme, shpenzimet për shportat e ITU për *Broadband* (fiks dhe mobile) në Shqipëri janë 1.28-1.87% e GNI, që konsiderohen të përballueshme.

Këto nivele të shpenzimeve për *Broadband* Bazik, në raport me GNI, janë gjithashtu poshtë nivelit të synuar prej 2% për përballueshmërinë e tarifave *Broadband* në vitin 2025, të Komisionit për *Broadband* të Kombeve të Bashkuara. Në përgjithësi, ndërmjet viteve 2008-2015, shpenzimet mesatare mujore për *Broadband* kanë rënë me 80%, nga 32 USD në 2008 në 6.3 USD në 2015.[8]

Në lidhje me gatishmërinë për të paguar, Raporti i WBIF 2019 për diagnostifikimin digjital, zbulon se çmimi mesatar i paguar për shërbimet e telefonisë celulare është 10 euro ose 1200 lekë dhe çmimi mesatar i paguar për shërbimet e telefonisë fikse është 2000 lekë. Tarifat midis 2000-2500 lekë për 30 mbps, konsiderohen si një çmim i përballueshëm. Shërbimet me shpejtësi 50 mbps ose më të lartë, ende nuk konsiderohen si të kërkuara për jetën e përditshme të qytetarëve. Megjithatë niveli i përballueshmërisë nuk është i njëjtë për zona të ndryshme, në veçanti në zonat rurale.

[6] Përzierja e teknologjisë krahasohet mjaft mirë me shifrat e BE-së (2015), ku *Broadband* jepet përmes 69% të lidhjeve DSL / VDSL, dhe kabllove 19% (nga të cilat 80% u shpërnda përmes Cable DOC SIS 3.0). Sa i përket aksesit NGA në BE, 35% e abonimeve *Broadband* janë shpërndarë duke përdorur VDSL, FTTH / B dhe Cable DOC SIS 3.0.

[7] Bazuar në të dhënat e raporteve të ITU "Measuring the Information Society Report 2016–2018".

[8] Shiko: Raportin e Sofrecom 2016, f. 19

Kërkesa për *Broadband*

Zhvillimet e shërbimeve elektronike

Për sa i përket kërkesës dhe stimulimit të kërkesës për *Broadband*, që nga miratimi i dokumentit të parë për Planin Kombëtar të *Broadband*-it në vitin 2013, është bërë një progres domethënës. Si një palë kryesore për zhvillmin e *Broadband*-it, Qeveria Shqiptare, ka bërë përpjekje konkrete për të stimuluar kërkesën për shërbime TIK: 1) duke vepruar vetë si një konsumator i rëndësishëm i shërbimeve digjitale, duke blerë një sërë shërbimesh për infrastrukturën e rrjetit të saj e-government nëpërmjet AKSHI-t; 2) duke krijuar shërbime TIK të centralizuara për institucionet qeveritare (si lidhje interneti nëpërmjet *Broadband*-it, shërbimet e-mail, shërbimet web dhe hosting, databazat MIS dhe e-shërbimet); dhe 3) duke ofruar shërbime elektronike te qytetarët, bizneset dhe vetë administratën.

Në vitin 2015 u krijua portali e-Albania[9], i cili shërben si një platformë *one-stop-shop* për shërbimet elektronike të të gjitha institucioneve qeveritare, agjencive dhe autoriteteve. Pothuajse 600 shërbime elektronike gjenden sot në portal, dhe 53 sisteme elektronike janë të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, nëpërmjet së cilës gjatë vitit 2019, janë kryer më shumë se 70 milionë transaksione. Portali e-albania, numëron më shumë se 1,300,000 përdorues të regjistruar në vitin 2019.

Shërbimet e-Goverment, gjenden në pothuajse të gjitha 61 bashkitë e Shqipërisë, dhe numri i qytetarëve dhe bizneseve që po përdorin shërbimet që ofron portali[10], të cilat janë të aksesueshme dhe nëpërmjet telefonit celular, po vjen gjithnjë e në rritje. Çdo muaj në portalin e-Albania, numërohen rreth një milion përdorime të shërbimeve elektronike, me 17 milionë përdorime gjatë vitit 2019 dhe katër muajve të parë të vitit 2020. Shërbimet përfshijnë aplikime për certifikata personale, për karta shëndeti, aplikime për leje ndërtimi, aplikime për pasaportë ose kartë identiteti, dhe shumë të tjera.

Figura 5. Përdoruesit e rinj për periudhën 2013–2020 dhe ndërfaqja e re e portalit e-Albania



Burimi: AKSHI, https://e-albania.al/

[9] Portali qeveritar e-albania.al është zhvilluar dhe administruar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) si një portal shumëfunksional, dhe konsiderohet si një *one stop shop*. Ofron shërbime 24 orë, 7 ditë në javë. Portali filloi si një investim i Bashkimit Evropian më 2009. Në fazën e hershme, ishte shumë i thjeshtë, përfshinte 6 shërbime elektronike dhe 4 sisteme të lidhura me Platformën e Ndërveprimit të Qeverisë. Portali është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura themelore që kombinon pajisjet, programet kompjuterike dhe shërbimet që mundësojnë bashkëveprimin midis të gjitha sistemeve të lidhura të institucioneve qeveritare.

[10] Sidoqoftë, duhet të theksohet se në një numër bashkish nuk kanë gjerësi brezi të mjaftueshme për shërbimet e ofruara, dhe one-stop-shop nuk janë funksionale në shumë NJQV. Në shumë NJQV kanë mungesë në pajisje dhe ekspertizë në TIK.

Përdorimi i TIK nga biznesi

Në lidhje me përdorimin TIK në ndërmarrjet private, anketimet nga Instituti i Statistikave (INSTAT), tregojnë se në vitin 2018, në 11 aktivitete ekonomike, më shumë se 95% e ndërmarrjeve të të tre klasave të madhësive të anketuara, kishin akses në internet (përfshirë këtu 6 aktivitete ekonomike me 100% akses në internet).

Numri i ndërmarrjeve me lidhje në internet, u rrit nga 88.4% në vitin 2017, në më shumë se 95% në vitin 2018. Lidhjet e internetit mundësohen kryesisht nëpërmjet DSL, në pjesën më të madhe të lidhjeve (72.7%) me një maksimum shpejtësie shkarkimi ndërmjet 2 mbits/s - <30 mbits/s. Numri i ndërmarrjeve me një shpejtësi shkarkimi më të lartë se 10 mbit/s u rrit në 56.3% në vitin 2018, nga 45.8% në vitin 2017.

Figura 6. Ndërmarrjet, sipas klasës së madhësisë, me qasje në internet (në të majtë) dhe shpejtësia maksimale e mundshme e shkarkimit (në të djathtë)



Burimi: Instituti i Statistikave, 2018

Në lidhje me përdorimin e *Broadband*-it nga qytetarët, Shqipëria ka bërë përparime të mëdha në penetrimin dhe përdorimin e internetit. Sipas vrojtimit të INSTAT-it të vitit 2019, për përdorimin e TIK nga individët dhe familjet, rezulton se në shkallë vendi 82.2% e familjeve shqiptare kanë akses në internet. Me shume se 56.6% e tyre kanë lidhje *Broadband* Fiks, dhe 88.9% e familjeve kanë akses interneti nga celulari. 87.1% e shqiptarëve e përdorin internetin rregullisht për qëllime të ndryshme, përfshirë këtu, median sociale, blerjet *online*, dhe shërbimet financiare digjitale, duke rritur gjithashtu përfshirjen në sektorin publik, nëpërmjet shërbimeve elektronike (e-services). Sipas statistikave, në total janë 1.5 milionë përdorues aktivë të mediave sociale (ose 51% e popullsisë). Numri i përdoruesve të mediave sociale, që aksesojnë internetin nëpërmjet celularit të tyre, është 1.3 milionë ose 44% e popullsisë. Numri total i përdoruesve aktivë mujorë të Facebook, është 1.3 milionë, nga të cilët 87% e aksesojnë Facebook nëpërmjet telefonave të tyre celularë.

Për më tepër, trafiku total i internetit në rrjetet fikse dhe celulare, është rritur disa herë në vitet e fundit. Trafiku i internetit në vitin 2019, në rrjetet fikse, është dyfishuar, kundrejt vitit 2018, po ashtu trafiku i komunikimit të të dhënave në rrjetet celulare vijon të rritet. Me transformimin digjital të të gjithë sektorëve ekonomikë, zhvillimin e industrisë vertikale, zgjidhjeve inovatore *Smart Cities*, digjitalizimin e SME-ve, kërkesa për *Broadband*, në veçanti për *Broadband*-in Fiks, pritet që të vijë nga sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe zhvillimet në biznes (B2B) do të jenë një nga nxitësit kryesorë të kërkesës.

Ndarja digjitale

Infrastruktura TIK në qendrat urbane, është relativisht e zhvilluar mirë. Megjithatë ekziston një hendek ndërmjet zonave urbane dhe rurale: teksa zonat rurale përfaqësojnë 39.7% të popullsisë, vetëm 3.4% e popullsisë që banon në këto zona është e lidhur me internet[11], ndonëse në disa zona, kjo shifër është më e lartë. Veçanërisht e theksuar është ndarja urbano-rurale për penetrimin e internetit fiks. Teksa 12% e popullsisë urbane kanë akses *Broadband* në internetin fiks, në zonat rurale kjo shifër është vetëm 2%. Në nivel rajonal, kjo ndryshon në mënyrë të konsiderueshme.

Bazuar në totalin e popullsisë, sipas qarqeve për vitin 2019, del që zona me nivelin më të lartë të penetrimit për popullsi, është Tirana me 22%. Të gjitha qarqet, kanë një penetrim rural nën 5% (e llogaritur kjo si përqindja e numrit të lidhjeve fikse në zonat rurale kundrejt numrit total të lidhjeve për secilin qark).

Figura 7. Totali i penetrimit fiks, urban dhe rural, i internetit sipas qarqeve, për vitin 2019

	Tirane	Vlore	Durres	Shkoder	Korçe	Gjirokaster	Lezhe	Berat	Fier	Elbasan	Diber	Kukes
Total fixed Internet penetration	22%	14%	13%	13%	12%	12%	11%	10%	9%	8%	7%	5%
Urban penetration	21%	13%	10%	9%	10%	12%	10%	8%	7%	6%	4%	5%
Rural penetration	2%	1%	3%	4%	2%	1%	1%	2%	2%	2%	2%	1%

Burimi: AKEP. Numri lidhjeve fikse Broadband sipas qarqeve 2019, si dhe INSTAT-i për popullsinë rajonale, janar 2019

[11] Shiko: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf . Duhet të theksohet se mungesa e lidhjes rurale e ka nxitur qeverinë të përqëndrohet në zhvillimin e *Broadband*-it rural në veçanti, për shembull me vendimin e AKEP-it nr. 2648 të vitit, i cili miraton zona me dendësi të ulët të popullsisë për të zgjeruar dhe përmirësuar shërbimet e *Broadband*-it.

ITU-ja e ka identifikuar mungesën e konektivitetit rural, si "një nga boshllëqet më të mëdha" që pengon zhvillimin në vend.[12] Shifrat për linjat fikse rurale dhe urbane të AKEP-it për vitin 2019, tregojnë që 50% e të gjithë linjave fikse janë në qarkun e Tiranës, mesatarja e penetrimit urban qëndron tek 25%, kurse mesatarja e penetrimit rural qëndron rreth 5%.

Bazuar në rezultatet e Studimit të Fizibilitetit, në lidhje me shpërndarjen e lidhjeve fikse *Broadband* në vitin 2019, gati 90% e totalit të lidhjeve fikse janë në zonat urbane dhe 10% në zonat rurale. Ndarja digjitale midis zonave urbane dhe rurale mbetet e lartë.

Arsyet kryesore për ndarjen digjitale, janë mungesa e infrastrukturës dhe e kapaciteteve institucionale, por gjithashtu përballueshmëria ekonomike, për të dyja llojet e akseseve, si për *Broadband*-in Fiks, ashtu edhe atë mobile në veçanti në zonat rurale dhe në ato me pak të ardhura. Teksa, në zonat urbane, ka një gamë të gjerë shpejtësish me ofertë, me një gamë të gjerë çmimesh me një përballueshmëri ndërmjet 2–4% të PBB-së për frymë, në zonat rurale përqindja e shpenzuar e PBB për frymë për shpejtësitë mbi 16 mbps mund të shkojë deri në 27%.[13]

Raporti Diagnostifikues Digjital 2019 i WBIF19, jep njohuri më të detajuara për ndarjen digjitale sipas qarqeve, gjithashtu raporti identifikon zonat rurale ku ka vetëm një ose asnjë operator, kurse në zonat urbane ose nën urbane ka konkurrencë ndërmjet operatorëve lokalë dhe së paku një operator kombëtar.

Në lidhje me investimin e rrjetit, pjesa më e madhe e operatorëve lokale investojnë në qytete dhe zona turistike, në rrjetet me fibër, kurse operatorët kombëtarë investojnë kryesisht në qendrat e qyteteve. Ka një mungesë investimi në zonat rurale si shkak i mungesës ose përfitimeve të ulëta nga investimet.

Në qytetet e vogla, teknologjia e bakrit është ende zgjidhja kryesore për shërbimet e internetit, e megjithatë nga operatoret nuk janë parashikuar investime të mëtejshme në këtë teknologji. Në ndryshim nga kjo, në shumë zona rurale përdoret teknologjia pa tel (WIFI). Kabllot ajrorë gjenden në pjesën më të madhe të qyteteve dhe të fshatrave. Sa i takon infrastrukturës mobile 4G, ajo është prezente në qytetet, por jo në të gjitha zonat rurale.

Përgjatë viteve 2018-2020, vërehet që në shumë prej këtyre qyteteve, sipërmarrësit e vegjël kanë filluar zhvillimin e rrjeteve të fibrave optike, ndërsa operatorë audiovizualë, që më parë ofronin vetëm rrjete koaksiale dhe shërbime TV, kanë filluar ndryshimin e rrjetit kryesor (dhe në disa raste të të gjithë rrjetit koaksial), duke e kthyer në rrjet me fibra optike, nëpërmjet të cilit po ofrojnë edhe shërbimin internet.

Kjo vihet re gjithashtu edhe në shumë zona rurale, ku janë investuar rrjete të reja me fibra optike dhe janë përmirësuar rrjetet koaksiale audiovizuale me fibra optike, ku gjithashtu vazhdojnë të përdoren teknologji pa tela në brezat 2.4 dhe 5.5 GHz (WiFi).

Gjatë viteve të fundit, AKEP-i ka luajtur një rol të rëndësishëm në reduktimin e rrjeteve ajrore, duke kërkuar nga operatorët e rrjeteve fikse, të zbatojnë rregullat teknike të vendosura nga AKEP-i, për sa i përket mënyrës së ndërtimit të tyre si dhe sigurisë. Për sa i takon infrastrukturës mobile 4G, ajo është prezente në qytete dhe rrugët nacionale, por jo në të gjitha zonat rurale.

Megjithatë konkurrenca është më e fortë në tregun celular, me të tre operatorët që janë prezent në pjesën më të madhe të zonave. Në lidhje me cilësinë e shërbimit, ai është relativisht i mirë në qytete, kurse në zonat rurale dhe periferike, cilësia e shërbimit është e dobët dhe ka nevojë për përmirësime, për t'u mundësuar p.sh. bashkive të ofrojnë shërbime digjitale për qytetarët e tyre. Shërbimet *one-stop-shop*, nuk janë funksionale në disa njësi të qeverisjes vendore, shkollat dhe spitalet janë në përgjithësi të lidhura me internet, megjithatë shpejtësia ka nevojë për përmirësim. Në zonat e thella rurale dhe të largëta nuk ofrohet fare lidhje.

Realizimi i objektivave dhe qëllimeve sipas Planit Kombëtar të *Broadband* 2013

Në një vështrim të përgjithshëm të progresit, lidhur me objektivat e përgjithshëm dhe qëllimet e Planit Kombëtar të *Broadband*-it në periudhën 2013–2020, rezulton se ka realizim të objektivave në lidhje me:

- Përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të *Broadband*

[12] Shiko: ITU (2016), *ICT Centric Innovation Ecosystem Country Review Albania*. https://www.itu.int/en/ITU-D/Innovation/Documents/Albania%20 Country%20 Review%20 Innovation%20 June%202016.pdf

[13] Shiko: Studimin e Sofrecom f. 56

- Rritjen e penetrimit *Broadband* me më shumë se dy herë
- Rritjen e konkurrencës dhe çmime më të ulëta të aksesit *Broadband*
- Shtimin e numrit të e-shërbimeve të disponueshme për shtetasit shqiptarë dhe digjitalizimin e të gjitha shërbimeve
- Rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë lidhur me përfitimet që dalin nga përdorimi i *Broadband*
- Dyfishimin e numrit të familjeve dhe kompanive me akses në *Broadband*

Ndërkohë mbeten të realizuara pjesërisht, ose janë në proces, realizimi i objektivave të tjerë, si lidhja me internet *Broadband* me shpejtësi të lartë e shkollave, internet *Broadband* në çdo klasë, ofrimi i shërbimit të internetit nga zyrat postare, pasi ka funksionuar vetëm për një periudhë kohe, lehtësimi i aksesit me 100 mbits për 50% të familjeve apo 30 mbits për të gjithë etj. Për përmbushjen e këtyre objektivave është iniciuar dhe ka filluar me mbështetjen e WBIF, Projekti për Zhvillimin e *Broadband*-it Rajonal.

Lidhur me çështjet teknike dhe rregullatore, sa i takon implementimit të Planit 2013–2020, ka pasur një numër të konsiderueshëm zhvillimesh rregullatore dhe ligjore që kanë nxitur zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*. Zhvillimi kryesor ligjor është miratimi i ligjit nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", që shënon fillimin e një reforme në zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*, duke krijuar hapësirat për bashkëpërdorimin e infrastrukturës ekzistuese të utiliteteve (transport, energji, gaz, ujësjellës) për Rrjetet *Broadband*, duke nxitur koordinimin e punimeve civile me qëllim reduktimin e kostove etj. Megjithatë zbatimi i këtij ligji, është ende në fillim dhe paketa e akteve nënligjore për implementimin e tij, pritet të plotësohet. Nga AKEP-i janë ndërmarrë disa aktivitete, që përfshijnë alokimet e spektrit të frekuencave për *Mobile Brodband*, heqjen e kufizimeve teknologjike në përdorimin e spektrit, krijimin e atlasit për infrastrukturën e telekomunikacioneve, si dhe janë marrë disa vendime e masa rregullatore, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte lidhen me zhvillimin e *Broadband*, si masat për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, analizat e rregullimit të tregjeve, rishikim të MTR-ve, heqjen e kufizimeve në përdorimin e spektrit, masa për të avancuar sigurimin e *Broadband*-it në zonat rurale dhe ato të largëta, si dhe masa të marra në fushën e roaming-ut ndërkombëtar.

Për një periudhë të shkurtër 2015–2017, u krijua Fondi Shqipëria Digjitale, për të mbështetur projektet e zhvillimit të infrastrukturës rurale dhe rajonale, TIK, e-qeverisja, e-learning etj. Megjithatë fokusi i zhvillimeve në lidhje me TIK, ka qenë digjitalizimi i infrastrukturës së administratës publike dhe shërbimet elektronike.

Mbi bazën e urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar", i cili krijoi Grupet e Menaxhimit të Integruar të Programeve ("GMIP") dhe Komitetet Drejtuese Strategjike, për të promovuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, agjencive të ndryshme qeveritare si edhe politikat dhe aktivitetet korresponduese, është krijuar Grupi Tematik për Telekomunikacionin dhe *Broadband*-in, si pjesë e Komitetit Drejtues Strategjik "Ndërlidhja", që drejtohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Nga viti 2016, zhvillimi i *Broadband*-it, është pjesë e projekteve kombëtare të rëndësisë strategjike (*National Single Pipeline*).

Në korrik 2017, në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe proceseve të integrimit Evropian, u miratua Plani i Zhvillimit Ekonomik të Vendeve të Ballkanit Perëndimor, MAP-REA. Integrimi digjital dhe në veçanti zhvillimi i infrastrukturës *Broadband*, janë pjesë e angazhimeve të rëndësishme të këtij plani.

Gjatë vitit 2017, me mbështetjen e UNDP-së, u krye studimi i parafizibilitetit për zhvillimin e *Broadband*it i fokusuar në katër rajone dhe në 13 bashki.

Shqipëria ka aplikuar me projekte të fushës së infrastrukturës digjitale, në të gjitha thirrjet e hapura nën WBIF për këtë sektor dhe ka përfituar disa projekte si: Projekti për Studimin e Fizibilitetit për Zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*. Shuma e grantit për këtë projekt, është 520 000 euro. Ky projekt është aktualisht në zbatim dhe përfundon në maj 2020. Po në kuadër të WBIF, është miratuar projekti pilot për zhvillimin e *Broadband*-it në zonat rurale (Shkodër, Kukës, Tropojë, Dibër) për dizenjim të detajuar, studimin e impaktit mjedisor dhe social dhe dokumentacionin e tenderit, si pjesë

e programit të 100 fshatrave. Granti i kërkuar për këtë projekt është 700 000 euro.

Gjithashtu është miratuar projekti rajonal për "Autostradën Digjitale Ballkanike", me pjesëmarrjen e Shqipërisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Granti i kërkuar për këtë projekt është 1 400 000 euro (për rajonin). Ky projekt synon rritjen e kapaciteteve të lidhjes digjitale në rajon, përmes bashkëpërdorimit të fibrës optike të operatorëve të transmetimit të energjisë për *Broadband*.

Në fokusin e zhvillimeve të infrastrukturës digjitale dhe *Broadband*, janë dhe zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për rrjetet e kërkimit dhe inovacionit si *High Performance Computer* (HPC).

Një listë me zhvillimet kryesore ligjore e rregullatore, si dhe tabela me një përmbledhje të objektivave dhe qëllimeve të përgjithshme siç parashikohen në Planin Kombëtar të *Broadband* 2013 dhe realizimi i tyre jepet në shtojcën bashkëlidhur.

Situata e përgjithshme e zhvillimit të *Broadband*, në veçanti e rrjeteve fikse dhe ndarja e theksuar digjitale midis zonave urbane dhe rurale, tregon nevojën e lartë për investime të rëndësishme për zhvillimin e infrastrukturës digjitale *Broadband* dhe se investimi vetëm nga sektori privat në zhvillimin e rrjeteve në veçanti në zonat rurale dhe të largëta është i pamjaftueshëm.

PROBLEMATIKA TË SEKTORIT DHE SFIDA TË ZHVILLIMIT *BROADBAND*

Ky seksion përmbledh problemet dhe sfidat kryesore të perceptuara nga palët e interesuara, në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*.

Në kuadër të hartimit të këtij dokumenti, operatorët e telekomunikacionit shprehen se për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të rrjeteve *Broadband* në Shqipëri, hasen me vështirësitë në marrjen e lejeve të ndërtimit, paqartësitë në legjislacionin dhe rregulloret ekzistuese lidhur me të drejtën e kalimit, vonesat në zbatimin e aktiviteteve dhe masave ekzistuese, të parashikuara në vendimet dhe ligjet e miratuara, konkurrenca e padrejtë nga ISP e palicencuara, moskthim të kostos së investimit në zonat rurale dhe të largëta, mbështetjen vetëm në sektorin privat për të investuar në infrastrukturë, mungesën e mekanizmave mbështetës me financime publike, të tilla si ndihma shtetërore ose fondi i shërbimit universal, disponueshmërinë e kufizuar të spektrit për shkak të vonesës në lirimin e dividentit digjital, si dhe tarifat e larta të spektrit për disa breza.

Problematikat kryesore të ngritura nga sektori grupohen në temat e mëposhtme:

- ndarja digjitale (Digjital Gap) dhe financimi për zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*;
- e drejta e aksesit dhe bashkëpërdorimi i infrastrukturës ekzistuese;
- menaxhimi i spektrit; dhe
- konkurrenca e ndershme;

Ndarja digjitale dhe nevoja e financimit.

Mungesa e ndërlidhjes rurale, është identifikuar nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit si "një nga boshllëqet më të mëdha" që pengon zhvillimin e vendit. Shqipëria ka bërë progres në zgjerimin e Penetrimit *Broadband* dhe të infrastrukturës së*Broadband*-it. Megjithatë, ndarja digjitale rural-urbane, vazhdon të jetë e konsiderueshme. Ndonëse janë ndërmarrë një numër aktivitetesh[14], të cilat adresojnë zgjerimin apo ndërtimin e infrastrukturës në zonat rurale dhe të largëta, pak progres është arritur deri më sot.

Një çështje kryesore e identifikuar gjatë takimeve dhe konsultimeve me grupet e interesit, e cila zvogëlon zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*, në veçanti në zonat rurale dhe të largëta, është mungesa e mekanizmave financues për infrastrukturën *Broadband*, si dhe mungesa e stimujve të duhur për të investuar. Momentalisht, për ndërtimin e infrastrukturës *Broadband*, nuk ekziston një fond për Shërbimin Universal dhe një mekanizëm për kontribut me fonde publike, nuk është aplikuar ndihmë shtetërore për *Broadband* dhe nuk ka buxhet publik të përcaktuar në nivel kombëtar ose vendor për ndërtimin e infrastrukturës *Broadband*. Sigurimi dhe ndërtimi i

[14] Për të adresuar këtë ndarje, AKEP, me bashkëpunimin e MNO-ve, miratoi vendimin nr. 2648, datë 3.12.2015, i cili miraton zonat me densitet të ulët të popullsisë që kërkojnë përmirësim të mbulimit *Broadband* mobile dhe Cilësinë e Shërbimit për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom. AKEP ka bashkëpunuar me autoritetet e pushtetit vendor për të siguruar lejet e ndërtimit për MNO-të, dhe një MNO tashmë ka bërë investimin përkatës në një nga zonat e përcaktuara. Vendimet për të ofruar shërbime *Broadband* në zona të tilla janë marrë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 300 (heqja e kufizimeve për teknologjinë dhe shërbimet) dhe në kuadër të veprimeve sipas "Planit për Shërbimin Universal në fushën e komunikimeve elektronike" 2013–2016".

infrastrukturës *Broadband*, ka qenë e varur pothuajse vetëm nga investimet e sektorit privat, operatorëve të rrjetit të telekomunikaconit. Shtrirja e infrastrukturës së telekomunikacionit është e kushtueshme, veçanërisht në ato zona ku ka shumë pak ose aspak infrastrukturë të mëparshme, dhe ku dendësia e popullsisë është e ulët dhe ku aksesi për shkak të vështirësive gjeografike është tepër i vështirë.

Në këto zona, nga ana e operatorëve ka pak ose aspak nxitje nga ana e operatorëve për të investuar në infrastrukturë, duke qenë se tarifat mesatare janë të ulëta (shiko Raportin Botëror të Teknologjisë së Informacionit WEF 2016 dhe studimin Sofrecom 2017) dhe një kthim të pritur në investim të ulët, për shkak të të dhënave kryesore demografike të popullsisë si: të ardhura të ulëta dhe aftësi për të paguar e ulët. Në lidhje me këtë, një pengesë e përmendur nga palët e interesit të industrisë, për të arritur një shoqëri digjitale, ka lidhje me faktin që rrjetet e aksesit NGA të disponueshme, nuk janë përdorur plotësisht. Në qytetet e mëdha, ku praktikisht ka rrjete të shpejtësisë së lartë, shpejtësia mesatare e Lidhjeve Fikse *Broadband*, mbetet e ulët, nën 30 Mbit/s.

Kjo ndodh kryesisht për shkak të mosgatishmërisë ose paaftësisë së pajtimtarëve, për të përmirësuar dhe paguar për shërbime të një cilësie më të lartë, duke cuar kështu në një përdorim jo efektiv të aksesit në infrastrukturën e gatshme të gjeneratës së re (NGA). Për më tepër cilësia e shërbimit nuk është vetëm e varfër në zonat rurale dhe të largëta, por është një çështje e rëndësishme edhe në qytetet e mëdha. Shkak për këtë është mbizotërimi i kabllove ajrorë, të cilët janë të ndjeshëm ndaj dëmtimeve.

Gjithsesi, përmirësimi dhe zhvillimi i Aksesit dhe Ndërlidhjes *Broadband*, mund të kontribuojë në përmirësimin e variablave demografike, duke ofruar mundësi dhe akses, si p.sh. në edukim, shërbime tregtare dhe publike dhe punësim. Për më tepër, siç tregohet në studimin Sofrecom 2017, në zonat rurale dhe të largëta, ka një kërkesë në rritje, veçanërisht nga njerëzit në katër rajone të studiuara (Shkodër, Kukës, Dibër dhe Korçë), të cilët presin përmirësimin e lidhjes dhe janë të gatshëm të shpenzojnë një tarifë mujore shtesë (edhe pse të ulët), për të pasur akses në aplikacionet dhe shërbimet që atyre iu nevojiten, përfshirë këtu aplikacionet personale, VoIP, aplikacionet e biznesit, e-shëndetësinë, e-qeverisjen, edukimin, sigurinë publike, tregtinë elektronike dhe turizmin[15].

Në mënyrë që të sigurohet, që kërkesa në rritje në zonat rurale dhe të largëta, të përmbushet nga një furnizim në rritje dhe i përmirësuar, duhet të realizohet kuadri i duhur ligjor dhe rregullator për nevojat për investime, duhet të rritet bashkëpunimi në të gjitha nivelet që promovojnë investimet në infrastrukturën digjitale dhe më e rëndësishmja, siç parashikohet edhe nga BE-ja me anë të udhëzimeve të reja për ndihmën shtetërore, duhet të krijohet një kuadër dhe mekanizëm për financimin publik.

Rregullimi i aksesit dhe përdorimi i përbashkët i infrastrukturës

Çështja e dytë e identifikuar, që pengon progresin në ndërtimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e saj, është procesi aktual i marrjes së lejeve të ndërtimit dhe marrjes së aksesit, në bashkëpërdorimin e infrastrukturës ekzistuese dhe alternative. Pothuajse të gjithë grupet e interesit shprehën vështirësitë dhe kompleksitetin në procesin e marrjes së lejeve të ndërtimit, marrjes së aksesit në bashkëpërdorimin e infrastrukturës ekzistuese dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për pronësinë e tokës.

Grupet e interesit vunë theksin te fakti që implementimi dhe veçanërisht zbatimi i saktë i masave, ligjeve e vendimeve dhe aktiviteteve që lidhen me to, nuk është ndërmarrë siç duhet. Për shembull, mund të bëhet inventari i infrastrukturës ekzistuese pasive të bashkive për ripërdorim për *Broadband*. Është akoma e paqartë nëse VKM-ja nr. 851, datë 7.12.2016, "Për transferimin e të dhënave mbi zgjerimin e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike të bashkive", është implementuar në mënyrën e duhur. Vendimi urdhëron institucionet përgjegjëse për infrastrukturën rrugore, ndërmarrjet e furnizimit me ujë dhe kanalizime, OSHEE sh.a, OST sh.a dhe kompani të tjera që operojnë në fushën e ujësjellës kanalizimeve dhe rrjetit energjetik, që të dorëzojnë te bashkitë përgjegjëse gjithë të dhënat dhe materialet kartografike rreth shtrirjes dhe kapaciteteve të rrjeteve dhe linjave të infrastrukturës dhe të njoftojnë bashkitë nëse ka ndryshime në këto rrjete. Për rrjedhojë, paketa e akteve zbatuese të ligjit të ri nr. 120/2016, duhet të

[15] Studimi Sofrecom 2016, f. 22.

zbatohet e plotësohet me të gjithë aktorët përkatës, veçanërisht nga autoritetet lokale, të cilët ose posedojnë infrastrukturë/linja pasive, si dhe kanë kompetencën e lëshimit të lejeve për ndërtimin e rrjetit (bashkitë, Autoriteti Rrugor).

Në lidhje me procesin e marrjes së lejeve të ndërtimit, ky është një problem i ngritur, si për ndërtimin e infrastrukturës fikse ashtu edhe atë mobile. Ky fakt mbështetet dhe nga rezultatet e Raportit të Diagnostifikimit Digjital WBIF2019, i cili nënvizon se duhen mesatarisht 15 deri më 40 ditë pune (nga këndvështrimi i bashkive) që operatorët të marrin leje për kryerjen e punimeve civile. Nga ana e tyre, industria nënvizoi se ky proces mund të zgjasë edhe më shumë – deri në 60 ditë. Raporti thekson më tej se ndërkohë që tubacionet ekzistojnë në shumë qytete dhe në disa raste edhe në zona rurale, duhet rregulluar aksesi në to. Për më tepër, në 50% të Njësive të Qeverisjes Vendore ("NJQV"), nuk ka pasur kërkesa për dhënien e lejeve për kryerjen e punimeve civile, si dhe është zbuluar se ka një mungesë organizimi nga ana e NJVV-e, për sa i përket shumicës së projekteve për ndërtim të rrugëve në lidhje me zbatimin e iniciativës "gërmo-një-herë".

Nga këndvështrimi i industrisë, proceset e instalimit të stacioneve të reja dhe marrjes së lejeve për BTS mobile, janë shumë të gjata dhe shpesh vonohen nga shumë kërkesa, të cilat kufizojnë realizimin e siteve të reja në kohë, duke zvogëluar në këtë mënyrë buxhetin e caktuar vjetor të MNO-s për ndërtim rrjeti.

Për sa u përket rrjeteve fikse, është e nevojshme harmonizimi i rregullave për lejet për infrastrukturë që aplikohen nga bashkitë, mungesa e personelit të dedikuar dhe e ekspertëve në bashki, si dhe mungesa e përcaktimit të qartë të përgjegjësive te rregullatorë të ndryshëm është gjithashtu një vështirësi.

Çështje kryesore mbetet harmonizimi i legjislacionit të planifikimit të territorit dhe shtrirjes së rrjetit të telekomunikacionit në nivel bashkie. Nevojitet një rregullim i procedurave për lëshimin e shpejtë të lejeve për punimet në infrastrukturë, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal, kjo për të shpejtuar procesin dhe nxitur investimet nga operatorët.

Në lidhje me bashkëpërdorimin e infrastrukturës ekzistuese, bashkëpunimi me dhe ndërmjet operatorëve të telekomunikacioneve, ndërmarrjeve të tjera dhe bashkive, nuk funksionon si duhet, si rezultat është e nevojshme dhe kërkohet ndërhyrje urgjente për të zvogëluar kostot e shtrirjes së rrjetit duke përdorur infrastrukturën ekzistuese alternative.

Për sa i përket rregullimit të aksesit në rrjetet *backbone*, aktualisht ekzistojnë dy operatorë kombëtarë të këtyre rrjeteve, por vetëm njëri është përcaktuar të ketë SMP dhe tarifat e aksesit në rrjetin *backbone* nuk janë të rregulluara. Kjo paraqet vështirësi për të marrë akses në infrastrukturën *backbone*. Për të lehtësuar aksesin është e nevojshme marra e masave, për:

- Lehtësimin e bashkëpërdorimit të infrastrukturës pasive mbi parime jodiskriminuese;
- Përshpejtimin e komercializimit të infrastrukturës së fibrës optike OST, si një mundësi për akses me kosto më efektive me fibër për MNO-të;
- Rregulloren simetrike për *Albtelecom*-in dhe ATU-në për transparencën e tarifave dhe shërbimeve, aksesin në infrastrukturën pasive dhe fibrën optike në lidhjet në nivel interurban;
- Kontrollin mbi çmimin e aksesit të tubacioneve/fibrës optike;
- Përmirësimin e informacionit që përmban ATLAS për rrjetet e komunikimeve elektronike.

Një gjetje kryesore e Raportit të Diagnostifikimit Digjital WBIF 2019, është mungesa e metodologjisë në nivel NJVV, kur ata lançojnë projekte të ndërtimit të rrugëve për zhvillimin e infrastrukturës pasive për rrjetet e shërbimeve të tjera dhe të telekomunikacionit. Bashkëpërdorimi mund të përmirësohet duke zbatuar një model, bazuar në parimet e iniciativës "gërmo një herë" dhe në çmime të rregulluara.

Për këtë qëllim, palët e interesuara të industrisë, theksuan që nevojiten një numër aktivitetesh, përfshirë ndërtimin e rrjeteve kabllore që aktualisht mungojnë dhe blerjen e pajisjeve në nyjat në nivelin e: 1) rrjeteve *backbone* për të mundësuar që një pjesë e infrastrukturës TSO-të komercializojnë në shkallë vendi – këto rrjete pastaj mund të lidhin qytetet me qytete brenda kufijve kombëtarë (brenda vendeve pjesëmarrëse); dhe 2) rrjete ndërkombëtare për të mundësuar bashkëpërdorimin ndërkufitar të fibrës optike të OST (OPGW) - këto rrjete pastaj mund të lidhin qytetet me rrjetet në vendet e tjera, të vendosura përtej kufirit (duke lidhur në këtë mënyrë vendet fqinje). Për më tepër,

bashkëpërdorimi i infrastrukturës energji-telekomunikacion, do të jetë një nga mjetet kryesore që do t'i japë shtysë bashkëpunimit rajonal.

Progresi ka qenë i ngadaltë, megjithëse janë identifikuar një numër vendimesh dhe aktivitetesh për adresimin e këtyre çështjeve. AKEP po bashkëpunon me autoritetet e qeverisjes vendore, për marrjen e lejeve të ndërtimit MNO, siç theksohet në Raportin Vjetor 2019 të AKEP-it. MIE po përgatit rregullore të përgjithshme për garantimin e të drejtave të kalimit.

OST-ja, i cili operon në fushën e energjisë elektrike, është pajisur se fundmi me Autorizim nga AKEP-i, për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit, ofrimin e aksesit në fibrën optike të OST-së për *Broadband*.

Aktivitete të tjera të AKEP-it, përfshijnë një seri dokumentesh të përmirësimit të SMP, mbi analizën e tregut LLU, aksesin *Broadband* (*bitstream*) dhe linjat me qira për të adresuar aksesin, rregullorja nr. 35, datë 10.7.2015 "Rregullat për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike", për të adresuar bashkëpërdorimin e infrastrukturës, koordinim me sektorin energjetik për të marrë informacion në lidhje me infrastrukturën e energjisë për ta përdorur për *Broadband*; bashkëpunim me Ministrinë/Qeverinë për përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për promovimin e *Broadband*-it të shpejtë dhe super të shpejtë, për lehtësimin e procesit të marrjes së lejeve për punime civile, bashkëpunim me autoritetet vendore për të garantuar lejet për operatorët për zhvillimin e infrastrukturës, veçanërisht në zonat e pambuluara me shërbime mobile. Gjithashtu, sipas VKM-së nr. 851, datë 7.12.2016 "Për kalimin e të dhënave mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike te bashkitë", AKEP-i po bashkëpunon me bashkitë për të lehtësuar procesin e mbledhjes së të dhënave mbi rrjetet telekom dhe identifikimin e mangësive. Çështja qëndron nëse ky proces po funksionin si duhet dhe nëse informacioni gjendet lehtësisht.

Menaxhimi i spektrit

Çështja e tretë që pengon progresin në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*, i referohet lirimit të Dividentit Digjital 2, d.m.th. lirimi i brezit të frekuencës 700 MHz. Progresi ka qenë i ngadaltë, për shkak se ky brez aktualisht përdoret për shërbime televizive dhe administrohet nga Autoriteti i Medias Audiovizive. Një çështje tjetër e ngritur nga grupet e interesit, janë tarifat e larta të frekuencave në brezin V dhe brezin E të frekuencave, gjë që sjell stepjen e tyre për të kryer investime, veçanërisht në kontekstin e 5G. Në lidhje me 5G, palët e interesuara gjithashtu theksuan se ankandi për bandën 3.5 MHz, nevojitet të përshpejtohet dhe të ndërmerret në vitin 2020 si një objektiv thelbësor i Planit Kombëtar të *Broadband*.

Në lidhje me lirimin e Dividentit Digjital 2 (brezi i frekuencave 694-790 MHz),[16] duke qenë një proces kompleks, MIE, AKEP dhe AMA kanë organizuar disa takime, për të diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me këtë proces dhe hapat e nevojshëm për implementimin e tij. Duke marrë në konsideratë kohën e nevojshme për realizimin e këtyre proceseve brenda afateve të përcaktuara nga vendimi BE 2017/899[17].

Çështja e dytë, që u përcoll nga grupet e interesit të industrisë, konsiston në tarifat e larta të spektrit për lidhjet mikrovalore në brezat V (60 GHz) dhe E (70/80 GHz). Lidhjet mikrovalore që përdorin brezin V ose brezin E janë një alternativë e mirë kundrejt fibrave optike dhe janë shumë të përshtatshme për rrjetin 5G

[16] Sipas AMA-s, zhvillimi i *Broadband*-it mobile në Shqipëri lidhet me procesin e lirimit të Dividentit Digjital 2 (694-790MHz). Bazuar në vendimin (BE) 2017/899 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 17 maj 2017 "Mbi përdorimin e brezit të frekuencave 470-790 MHz në BE" nga 30 qershori 2020, vendet anëtare duhet të lejojnë përdorimin e brezit të frekuencave 694-790 MHz ('700 MHz') për sistemet tokësore të afta për ofrimin e shërbimeve *Broadband* të komunikimeve elektronik *Broadband* pa tel (*wireless*). Vendet anëtare, gjithsesi, mund të vonojnë lejimin e përdorimit të brezit të frekuencave 700MHz deri në dy vjet në bazë të një ose disa arsyeve të justifikuara. Në Shqipëri brezi 700MHZ aktualisht është në bërdorim nga operatorët analog dhe digjital të transmetimeve audiovizive.

[17] Vendimi (BE) 2017/899 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të 17 maj 2017 "Mbi përdorimin e brezit të frekuencave 470–790 MHz në BE" nga 30 qershori 2020, vendet anëtare duhet të lejojnë përdorimin e brezit të frekuencave 694–790 MHz ('700 MHz') për sistemet tokësore të afta për ofrimin e shërbimeve *Broadband* të komunikimeve elektronik *Broadband* pa tel (*wireless*). Vendet anëtare, gjithsesi, mund të vonojnë lejimin e përdorimit të brezit të frekuencave 700MHz deri në dy vjet në bazë të një ose disa arsyeve të justifikuara.

(dhe rrjetin *Broadband* në përgjithësi), për shkak të kapaciteteve të transmetimit të të dhënave nga 10 Gbps në 25 Gbps.[18] Këto lidhje mikrovalore mund të përdoren për implementimin e shpejtë të rrjeteve *Backhaul Mobile* deri në stacionin fundor në çdo lloj zone (urbane, periferike dhe rurale), si rezultat i fleksibilitetit dhe i kostove të ulëta të instalimit.

Sa i përket 5G, palët e interesuara theksuan se 5G duhet të konsiderohet si një komponent i rëndësishëm në Shoqërinë Digjitale, në veçanti në kontekstin e rrjeteve celulare që në Shqipëri aktualisht janë më të përhapura sesa rrjetet fikse, lidhur kjo me penetrimin. Prandaj për të arritur qëllimet e ofrimit të shërbimit 5G në 2021, banda 3.5 GHz duhet të dalë në ankand sa më shpejt të jetë e mundur gjatë vitit 2020 dhe të jetë pjesë kyçe e Planit Kombëtar të *Broadband*.

Konkurrenca e ndershme

Një çështje e katërt e ngritur nga grupet e interesit që u përcaktua edhe si baza për zhvillimin e një infrastrukture *Broadband* të qëndrueshme, ishte konkurrenca e pa ndershme. Grupet e interesit theksuan që ndërsa tregu *Broadband* karakterizohet nga një konkurrencë e madhe, konkurrenca e çmimeve është ndonjëherë erozive dhe jo e qëndrueshme në terma afatgjatë, duke qenë se disa oferta janë poshtë kostove për ofrimin e shërbimit, zakonisht të ofruar nga ISP-të e palicencuara.

Shqipëria ka tarifat më të ulëta për *Broadband* Fiks, jo vetëm në BE, dhe në vendet fqinje të rajonit, por gjithashtu në mbarë botën, duke u renditur vendi i 7-të për tarifat fikse *Broadband* në Nënindeksin e Përballueshmërisë të Indeksit të Gatishmërisë së Rrjetit 2016, të Forumit Ekonomik Botëror[19]. Çështja e praktikave jokonkurruese në Shërbimet *Broadband*, është frenuese në investime dhe në zhvillimin e *Broadband*. Kërkohet vëmendje në adresimin e çështjes së praktikave të konkurrencës së pandershme apo veprimtarisë informale.[20]

Një çështje e dytë në lidhje me konkurrencën, qëndron tek aksesi në godina për qëllimet e ofrimit të shërbimeve. Grupet e interesit nga sektori privat, theksuan që bazuar në ligj, pronarët e ndërtesave duhet të lejojnë akses për secilin ofrues të shërbimeve, i cili do të konkurrojë për klientin fundor, por ata nuk e lejojnë këtë duke përdorur justifikimin e "ekskluzivitetit" për një ofrues. Kjo është një praktikë e paligjshme, e cila duhet të ndalohet nga autoritetet përkatëse. Në këtë kontekst MIE po harton rregullat për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimit elektronik me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikave të aksesit në godina.

Në mënyrë të përmbledhur kërkesat për adresimin e problematikave jepen në tabelën më poshtë:

[18] Shiko: https://www.gsma.com/futurenetworks/wiki/mobile-backhaul-an-overview/

[19] Shiko: http://www3.weforum.org/docs/GITR2016/WEF_GITR_Full_Report.pdf

[20] Shiko: Sofrecom f. 13

1. Ndërtimi i infrastrukturës *Broadband* - Harta e infrastrukturës – përmirësimi i Atlasit - Adresimi nga bashkitë dhe ministritë i dhënies së lejeve të ndërtimit për Rrjetet *Broadband* - Përmirësimi i Bashkëpërdorimit të infrastrukturës duke adresuar zbatimin e rregulloreve për të drejtën e kalimit - Promovimi i ndërtimit të rrjeteve NGN, duke përfshirë dhe 5G - Zhvillimi i *Broadband*-it në hapësirat publike/ Rrjetet WiFi - Adresimi i sigurisë së rrjeteve - Finalizimi i implementimit të Strategjisë 5G - Përforcimi i kuadrit institucional për zhvillimin e *Broadband*	**2. Përforcimi dhe zgjerimi fondeve dhe financimeve** - Përmirësim i kuadrit dhe iniciativave për investime nga sektori privat - Rishikim i Shërbimit Universal dhe Fondit të Shërbimit Universal - Financim publik/Përdorim i Ndihmës Shtetërore - Përdorim i Asistencës Ndërkombëtare
3. Menaxhimi i spektrit - Përfundimi i procesit dhe lirimi i Dividentit Digjital2 (brezi i frekuencave 700 MHz) Konsultim publik me grupet e interesit - Rishikimi i tarifave të spektrit	**4. Konkurrenca e qëndrueshme** - Ekzaminimi i praktikave të pandershme /palicencuara dhe marrja e masave - Sigurimi i zbatimit të përpiktë të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese

Burimi: Bazuar në përfundimet nga konsultimi me grupet e interesit

VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2020–2025

Ky dokument përcakton si vizion:

Shqipëria me infrastrukturë Digjitale Broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit

Për realizimin e këtij vizioni, përcaktohen këto objektiva strategjikë të zhvillimit të *Broadband*:

Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës *Broadband;*

Objektivi strategjik 2: Reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve *Broadband* gjithëpërfshirëse;

Objektivi strategjik 3: Rritje e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit.

Bazuar në analizën e mësipërme, sfidat për vendin, si dhe duke konsideruar aspiratat për të ecur në harmoni me strategjitë e Bashkimit Evropian, për krijimin e një shoqërie gigabit, të cilat jepen në mënyrë të përmbledhur në shtojcën e këtij dokumenti, objektivat e përgjithshëm të Planit të Parë Kombëtar të *Broadband*, janë ende të vlefshme dhe janë përshtatur me vizionin e përcaktuar dhe objektivat strategjikë të mësipërm. Objektivat specifikë kombëtarë për *Broadband*-in për periudhën 2020–2025, janë si më poshtë:

- **Nga fundi i vitit 2025**, të ketë penetrim *Broadband* në 100% të familjeve, bizneseve dhe institucioneve publike, ku:

- 50% të kenë mundësinë e marrjes se aksesit me shpejtësi shumë të lartë me të paktën 1 Gbps (zonat urbane – Tiranë);

- 50% të kenë mundësinë e aksesit me shpejtësi prej të paktën 100 Mbps;

- **Nga fundi i vitit 2025**, 100% e familjeve në zonat rurale dhe të largëta, të kenë mundësinë e aksesit (disponueshmerinë) e lidhjes me shpejtësi të paktën 100 Mbps;

- **Nga fundi i vitit 2025**, 100% e shkollave të jenë të lidhura me internet *Broadband* me shpejtësi të lartë 1 Gbps;

- **Nga fundi i vitit 2025**, 100% e universiteteve, të jenë të lidhura me *Broadband* me shpejtësi 1 Gbps;

- Rrjeti Akademik Shqiptar, të jetë pjesë e rrjetit evropian të High Performance Kompjuter (HPC);

- **Nga fundi i vitit 2025**, 100% e qendrave shëndetësore dhe spitaleve, të jenë të lidhura me *Broadband* me shpejtësi të lartë prej 1 Gbps;

- **Nga fundi i vitit 2025**, një qytet kryesor, korridoret kryesore të transportit dhe vendndodhjet strategjike, të jenë të mbuluara me lidhje 5G.

- **Nga fundi i vitit 2023**, 50% të hapësirave publike si parqe, biblioteka dhe sheshe, në të gjitha qytetet dhe fshatrat të ketë akses të lirë në lidhje WiFi.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale *Broadband* dhe arritja e objektivave strategjike, kërkon investime të mëdha. Sfidat kryesore të zhvillimit të *Broadband* lidhen me:

- Nxitjen dhe mbështetjen e investimeve për infrastrukturën digjitale *Broadband*;

- Sigurimi i Shërbimit Universal për *Broadband* dhe krijimi i skemave mbështetëse për zvogëlimin e ndarjes digjitale;

- Përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator për mbështetjen e investimeve në infrastrukturës *Broadband* për sigurimin e të drejtës së kalimit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës ekzistuese NGA;

- Zhvillimi i konkurrencës së ndershme të qëndrueshme;

- Rritja/forcimi i kapaciteteve në institucionet përgjegjëse për zhvillimin e *Broadband* si në nivel qendror (ministria e linjës, organi rregullator) dhe atë vendor ;

- Zhvillimi i koordinuar dhe i harmonizuar i politikave për zhvillimin e infrastrukturave të utiliteteve, për reduktimin e kostove të zhvillimit të infrastrukturës digjitale *Broadband*;

- Rritja e kërkesës përmes zhvillimit të shërbimeve digjitale dhe rritja e kërkesës nga industria vertikale përmes zhvillimit të aplikacioneve dhe zgjidhjeve inovatore për qytetet e mençura (*smart cities*), aplikimeve TIK në fushën e transportit, energjisë, sektorëve të tjerë të ekonomisë, digjitalizimin e SME-ve;

- Zhvillimin e rrjeteve kompjuterike të performancës së lartë (HPC) në shërbim të rrjetit akademik dhe kërkimit shkencor;

- Zhvillimin e aftësive digjitale për të rritur kërkesën dhe përfitimet nga përdorimi i infrastrukturës *Broadband* dhe gjithë shërbimeve dhe zhvillimeve aplikative si Iot, AI, të mbështetura në to.

Masat mbështetëse për arritjen e objektivave:

- Nga fundi i vitit 2020, të jetë vendosur një proces i qartë me përgjegjësi të qarta, në lidhje me aplikimin dhe dhënien e lejeve të ndërtimit.

- Brenda datës 30.6.2022, të lirohet brezi 700 MHz nga operatorët e transmetimeve audiovizive dhe ky brez të ricaktohet te MNO.

- Nga fundi i vitit 2020–2021, të jenë ngritur zyrat kompetente të *Broadband*-it dhe të caktohen përgjegjësitë në nivel bashkiak.

- Nga fundi i vitit 2021, të jetë ngritur Fondi i SHU, duke përfshirë një mekanizëm financimi publik dhe rregulla të qarta për disbursim.

- Nga fundi i vitit 2020, të jenë miratuar rregullat për ndihmën shtetërore.

- Nga fundi i vitit 2022, të jetë përditësuar Atlasi, duke përfshirë të gjithë operatorët e infrastrukturës aktive dhe ofruesit e infrastrukturës alternative, si nga sipërmarrësit e regjistruar në AKEP për rrjete të komunikimeve elektronike, ashtu edhe nga bashkitë, në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 851, datë 7.12.2016 "Për kalimin e të dhënave mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike te bashkitë".

- Nga fundi i vitit 2022, të jetë krijuar një inventar i infrastrukturës alternative që mund të përdoret për *Broadband*, duke përfshirë shërbimet dhe infrastrukturën pasive të përdorur nga bashkitë.

- Nga fundi i vitit 2022, të jenë ngritur mekanizmat e financimit dhe sigurimit për rrjetet publike WiFi.

- Nga fundi i vitit 2022, të jetë adresuar çdo praktikë antikonkurruese që dëmton zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*.

Masat për përmbushjen e objektivave dhe prioriteteve

Në lidhje me objektivat strategjikë për: zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës *Broadband*, reduktimin e ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve *Broadband*, dhe rritjen e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit, prioritetet e sektorit për periudhën 2020–2025, përfshijnë çështje të një niveli të lartë rëndësie si: promovimi i ndërtimit të rrjeteve së gjeneratës të së ardhmes NGN, zhvillimi i infrastrukturës e shtrirja e fibrës optike, përfshirë zhvillimin e rrjeteve Mobile *Broadband* NGN (lirimi i brezit 700 MHz dhe spektrit tjetër për 5G), avancimi i hartëzimit të infrastrukturës dhe bashkëpërdorimi i infrastrukturës në nivel vendor dhe kombëtar.

Përmirësimi i atlasit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duke përfshirë informacionin deri në pikën fundore të rrjetit, informacionin për rrjetet ekzistuese pasive që mund të përdoren për *Broadband*, krijimi i një inventari të infrastrukturës pasive ekzistuese të bashkive për ripërdorim për rrjetet *Broadband*, krijimi i mekanizmave nxitës për investime për infrastrukturës *Broadband* në zonat rurale dhe të largëta, duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator, për të përfshirë fonde publike përmes

Shërbimit Universal dhe ndihmës shtetërore, bazuar në praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. Këto janë masat që do të merren në këtë drejtim.

Prioritetet e sektorit privat, lidhen me zgjerimin e mbulimit të *Broadband-Mobile* në të gjithë vendin, si dhe në zona të thella, duke aplikuar LTE në 800 MHz, plane për investim për rritjen e kapaciteteve për të përmbushur kërkesat e mëdha për të dhëna, për zgjerimin e rrjetit me fibër optike, ndërtimin e siteve të reja, për densifikimin e rrjeteve në zonat urbane e turistike dhe mbulimin e zonave rurale të largëta apo fshatrave të izoluara, rritjen e përdorimit të qelizave të infrastrukturës së rrjetit për vënien në përdorim të 5G. Implementimi dhe zbatimi korrekt i ligjeve e rregulloreve për aksesin dhe bashkëpërdorimin e infrastrukturës në lidhje me të drejtën e kalimit, do jetë në fokus për të bërë të mundur realizimin e këtyre prioriteteve. Thjeshtimi i procedurave dhe reduktimi i kohës për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe lejeve për instalimet e reja të siteve, gjithashtu, do të jetë pjesë e masave për nxitjen e zhvillimit të rrjeteve *Broadband*. Prioritet tjetër garantimi i konkurrencës dhe investimeve të qëndrueshme.

Përmirësimi i Atlasit *Broadband*

Aktivitetet e propozuara:

- Përmirësim i Atlas-it dhe përfshirja e infrastrukturës së të gjithë operatorëve lokalë, të cilët nuk janë të përfshirë aktualisht dhe infrastruktura alternative e bashkive dhe komunave që mund të përdoret për zhvillimin e Broadband.

- Përmirësim i procesit të mbledhjes së të dhënave, duke rritur bashkëpunimin me autoritetet lokale, bashkitë dhe institucionet.

- Përditësim i rregullores për Atlas-in dhe mbajtja e një konsultimi publik.

Përgjegjësia:

- AKEP, MIE

- Autoritetet lokale, bashkitë,

- Operatorët e rrjeteve

Afati kohor: 2020–2022

Përmirësimi i klimës së investimeve

Adresimi i dhënies në kohë të lejeve për ndërtim të rrjetit dhe e drejta e kalimit, nga bashkitë apo institucionet qendrore, janë prioritet kryesor dhe kusht paraprak kryesor që grupet e interesit të kryejnë investime. Për të nxitur operatorët që të investojnë duhet të bëhen përmirësime të rëndësishme në procesin e aplikimit, afate strikte, si dhe në ngritjen e kapaciteteve në nivel bashkiak.

Aktivitetet e propozuara:

- Përmirësim i procedurave për lejet e ndërtimit për zhvillimin e rrjeteve Broadband, duke përfshirë procedura miratimi më të shkurtra dhe efektive.

- Thjeshtim i proceseve aktuale (rishikimi i listës së dokumenteve të kërkuara) - përjashtime për lloje të ndryshme projektesh infrastrukture gjithashtu në kontekstin e zhvillimit të siteve/celave të vogla.

- Përmirësim i koordinimit dhe bashkëpunimit midis bashkive, ministrive dhe enteve rregullatore për çështjet e rrjeteve Broadband.

- Rritja e kapaciteteve dhe ekspertëve, caktimi i përgjegjësive në çdo bashki.

- Organizimi i një konference kombëtare vjetore për infrastrukturën Broadband.

Përgjegjësi:

- MIE për qëllime koordinimi

- AZHT

- AKEP, institucione të tjera të lidhura

- Bashkitë dhe entet rregullatore për koordinim vendor dhe për përcaktimin e procedurave më të thjeshtuara/ one stop shop (portali e-Albania)

Afati kohor: 2020–2022

Bashkëpërdorimi infrastrukturës ekzistuese

Prioriteti i dytë i identifikuar nga grupet e interesit të sektorit publik dhe privat, për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës, në një mënyrë që kostoja të jetë sa më efektive, është përmirësimi i bashkëpërdorimit të infrastrukturës.

Kjo përfshin bashkëpërdorimin e infrastrukturës në nivel bashkiak, gjithashtu në lidhje me kryerjen e projekteve për ndërtimin e rrugëve dhe zhvillimin paralel të infrastrukturës pasive, të nevojshme për shërbime të tjera të utiliteteve dhe për rrjetet e telekomunikacionit. Rregullimi i aksesit në infrastrukturat ekzistuese backbone (Albtelecom, ATU), si dhe mundësimi i përdorimit të rrjetit të fibrës optike të OST-së, që do të rrisë konkurrencën në ketë pjesë të tregut.

Aktivitetet e propozuara:

- Analiza dhe adresimi i pengesave për bashkë përdorimin e infrastrukturës;

- Implementim dhe zbatim i ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese mbi bashkëpërdorimin e infrastrukturës;

- Rregullimi i aksesit në infrastrukturën backbone;

- Rregullimi i aksesit në godina;

- Inventarizim i infrastrukturës alternative, të zotëruar nga kompanitë e shërbimeve publike dhe i infrastrukturës

pasive që mund të ripërdoret për Broadband – përfshirje në Atlas;

- Inventarizim i infrastrukturës pasive në zotërim të bashkive;

- Avancim i procesit të licencimit për ofruesit alternativë të infrastrukturës.

Përgjegjësia:

- MIE – për finalizimin dhe implementimin e ligjeve ekzistuese dhe akteve nënligjore/legjislacioni dytësor brenda vitit 2020

- AKEP - për adresimin e ndonjë pengese rregullatore për bashkëpërdorimin e infrastrukturës

- Bashkitë - për të siguruar një zbatim korrekt të ligjeve dhe për të mundësuar inventarizimin e infrastrukturës alternative të disponueshme për t'u ripërdorur

- Rregullatorët e utiliteteve (energji, transport, gaz, ujë);

Afati kohor: 2020–2025

Si pjesë e rregullimit të aksesit në infrastrukturën ekzistuese janë dhe masat për:

- Përshpejtimin e komercializimit të infrastrukturës së fibrës optike OST, si një mundësi për akses me kosto më efektive me fibër për MNO-të.

- Zbatimin e rregulloreve simetrike për Albtelecom dhe ATU, për transparencën e tarifave dhe shërbimeve, aksesin në infrastrukturën pasive dhe fibrën optike, në lidhjet në nivel interurban.

- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet OSHEE-së dhe operatoreve të rrjeteve fikse mbi rregullimin e përdorimin e infrastrukturës pasive, mbështetur në aktmarrëveshje ndërmjet palëve.

- Kontrollin mbi çmimin e aksesit të tubacioneve/fibrës optike.

- Përmirësimin e informacionit që përmban ATLAS për rrjetet e komunikimeve elektronike.

Cilësia e shërbimit dhe mbrojtja a konsumatorit

Në Planin Kombëtar për Integrim, për periudhën 2020-2022, është parashikuar transpozimi i direktivës së re të BE-së 2018/1972/EU, Kodi i Komunikimeve Elektronike (EECC), gjatë vitit 2021. Me ndryshimin e ligjit për komunikimet elektronike, do të përmirësohen kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit.

Në këtë kuadër, AKEP-i do të zhvillojë një platformë *online* (*Measuring tool*), ku do t'u sigurojë qytetarëve mundësinë që të kryejnë ankesa në kohë reale, në lidhje me shërbimin e internetit, p.sh. cilësinë e tij. Çdo përdorues fundor mund ta përdorë platformën për matjen e shpejtësisë aktuale të internetit, duke bërë krahasimin me shpejtësinë e dakordësuar në kontratë. I njëjti mjet mund të përdoret gjithashtu për të verifikuar disponueshmërinë e shërbimit universal.

Nëpërmjet kësaj platforme AKEP do të jetë në gjendje të analizojë dhe të publikojë të dhënat mbi cilësinë e ofruar të shërbimit të operatorëve të internetit, duke shfaqur të dhëna mbi cilësinë e shërbimit (QoS), rankimin e operatorëve dhe trajtimin e ankesave të përdoruesit duke nxitur ofrimin e shërbimit me cilësi të lartë sipas praktikave më të mira rregullatore të zhvilluara në vendet evropiane.

Strategjia dhe implementimi i 5G

Në shtator të vitit 2016, Komisioni Evropian publikoi Planin e Veprimit 5G për Evropën,[21] për t'i dhënë një shtysë realizimit të rrjeteve të telekomunikacionit të gjeneratës së 5-të në BE. Komisioni theksoi nevojën për një qasje të koordinuar, për të siguruar aplikimin e menjëhershëm të teknologjisë 5G në BE. Ministrat evropianë për telekomunikacionet, u përgjigjën në dhjetor 2017, duke miratuar një udhëzues ambicioz, i cili do ta shndërrojë Evropën në lider botëror në teknologjinë 5G. Udhëzuesi paraqet nevojën për të vënë spektrin në dispozicion sa më shpejt dhe në mënyrë më të parashikueshme, që rrjetet 5G të vendosen shpejt, me qëllim që:

- 5G të jetë e disponueshme në të paktën një qytet për çdo vend anëtar deri në vitin 2020.

- Të promovohet vendosja e 5G midis viteve 2018 dhe 2025.

- Të krijohet "Shoqëria Gigabit", deri në vitin 2025, duke vendosur 5G në qytetet dhe qytezat kryesore, si dhe përgjatë rrugëve kryesore të transportit.

Shqipëria si vend kandidat për anëtarësim në BE, është e angazhuar të harmonizojë politikat e saj kombëtare, në lidhje me zhvillimin e komunikimeve elektronike, me ato të BE-së, të cilat do të harmonizohen me objektiva strategjikë të iniciativës të BE-së në vitin 2010 mbi Agjendën Digjitale për Evropën[22], si një strategji

[21] 5G për Evropën: Plani i veprimit: https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/communication-5g-europe-action-plan-and-accompanying-staff-working-document

[22] Komunikata nga Komisioni për ParlamentinEvropian, Këshillin, Komitetin Evropian

gjithëpërfshirëse për zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe strategjinë e BE-së e vitit 2016 "Drejt një Shoqërie Gigabit për vitin 2025"[23]. Përdorimi i internetit përmes celularit dhe rrjetet mobile *Broadband*, janë mbizotëruese në Shqipëri. Mobile *Broadband*, dhe 5G do të jenë një komponent kryesor i infrastrukturës kombëtare në Shqipëri. Në lidhje me zhvillimin e rrjeteve 5G do të synohet:

1. Lehtësim i vënies në dispozicion në kohë i spektrit;
2. Thjeshtim, përmirësim i proceseve dhe reduktim i kompleksitetit për lejet e ndërtimit;
3. Adresim i çështjeve mjedisore dhe zhvillimi miqësor me ndikim minimal në mjedis;
4. Promovim i ndërgjegjësimit mbi mundësitë dhe përfitimet nga 5G;
5. Garantimi i sigurisë se rrjeteve dhe mbrojtja e konsumatorëve.

Aktivitet i propozuar:

- Finalizim i dokumentit për 5G hartimi i një Plani Veprimi;

- Implementim i rekomandimeve kryesore të përfshira në Strategjinë dhe Udhëzuesin 5G;

- Adoptimi i masave të sigurisë/besueshmërisë së rrjeteve sipas praktikave të mira ndërkombëtare.

Përgjegjësia:

- MIE – kuadri ligjor;

- AKEP – Alokimi i spektrit të disponueshëm;

- AMA – sigurimi që spektri DD2 të jetë i disponueshëm;

- Bashkitë - akses në infrastrukturën publike;

- Operatorët e rrjetit – ndërtimi i rrjetit, akses;

- AZHT, Ministria e Shëndetësisë;

- Të tjerë;

Afati kohor: 2020–2022

Frekuencat e ulëta të brezit të dividentit digjital janë ideale për mbulimin e zonave të mëdha me një numër të vogël stacionesh. Lirimi i këtyre brezave dhe alokimi për MNO-të janë shumë të rëndësishme për të siguruar mbulim në zona rurale në mënyrë ekonomikisht të qëndrueshme. Në disa vende, përfshirë vende të rajonit si Mali i Zi, alokimi i brezave 800 MHz është shoqëruar me kushte specifike mbulimi për një apo disa të drejta përdorimi për mbulim të zonave rurale me dendësi të ulët. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të bashkëpunojë me AKEP-in për vendosjen e kushteve specifike për sigurimin e mbulimit të zonave rurale në kuadër të dhënies në përdorim të brezave dividentit digjital;

duke u angazhuar dhe në marrjen e masave të nevojshme rregullatore për zhvillimin e rrjeteve, si e drejta e kalimit, harmonizim të procedurave dhe tarifave të aplikuara nga bashkitë (sidomos në zona rurale), promovim të përdorimit të përbashkët të infrastrukturës pasive dhe aktive të rrjeteve celulare në zonat rurale. Përdorimi i këtyre instrumenteve nga praktika ndërkombëtare vlerësohet se është metoda më efektive për promovimin e mbulimit të zonave rurale me rrjete celulare që mundësojnë akses BB dhe reduktimin e hendekut digjital me zonat urbane.

Rrjetet WiFi për publikun

Bazuar në praktikën më të mirë të BE-së për WiFi4EU, një iniciativë që promovon lidhjen WiFi pa pagesë në dhe përreth godinave publike, qendrave shëndetësore, parqeve ose shesheve, ndërtimi i rrjeteve WiFi do të shikohet mundësia e realizimit të WiFi për qendrat publike në bashkëpunim me bashkitë, autoritetet e tjera të lidhura me zhvillimin e infrastrukturave TIK, Posta Shqiptare etj.

Aktivitet i propozuar:

- Adresim i çështjes së financimit të infrastrukturës së re, përfshirë sigurimin e fondeve për rrjetet WiFi publike.

- Krijimi i mundësisë së marrjes së shërbimeve publike elektronike dhe lidhjes internet në zyrat e Postës Shqiptare.

Përgjegjësia:

- Përgjegjësia kryesore për koordinim i përket MIE

- AKEP– për të mbështetur Shërbimin Universal Ministria e Financave dhe Ekonomisë – ndihma shtetërore

- AKSHI

- Krijimi i fondeve për mbështetjen e infrastrukturës Broadband në zonat rurale/zhvillimet në bujqësi Ministria e Bujqësisë

- Fondet e zhvillimit rajonal – ndërtimin e infrastrukturës pasive

- Pushteti vendor – alokim i buxhetit për rrjetet Broadband/infrastruktura pasive

- Posta Shqiptare,

- Operatorët e rrjetit – investimi dhe ndërtimi privat

Shënim: Disa rekomandime për skemën e duhur priten nga Studimi i Fizibilitetit, WBIF/IPF8

Afati kohor: 2020–2025

Social dhe Ekonomik dhe Komitetine Rajoneve, COM (2010) 245 final, "Agjenda Digjitale për Evropën"https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:52010DC0245R(01)

[23] COM (2016) 587

Adresimi i sigurisë së rrjeteve *Broadband*

Një prioritet kryesor në zhvillimin e infrastrukturës *Broadband* është përdorimi i sigurt, i mbrojtur dhe i besueshëm i aksesit internet *Broadband*, i cili nuk duhet të ketë kërcënime kibernetike. Rrjetet e telekomunikacionit janë të ekspozuara ndaj dëmtimeve të rrjetit, që mund të cenojnë integritetin e tij duke sjellë pasoja në aksesin e paautorizuar në rrjet, humbje të konfidencialitetit të komunikimit, si dhe rrezikun e disponueshmërisë së shërbimeve të komunikimit, të domosdoshme në ditët e sotme. Tendencat e zhvillimit në telekomunikacion, zhvillimet e pritshme si kalimi në rrjetet e gjeneratës 5G, pritet të sjellin ndryshime të rëndësishme në komunikime me prezantimin e aplikimeve/modeleve të reja të komunikimit të lidhura me industrinë (transportin, energjinë, shëndetësinë etj.), me institucionet publike, komunikimet midis pajisjeve (internetin e gjërave (IoT), komunikimet masive të makinave (mMMC) etj. Këto zhvillime po shoqërohen në nivel global me rritjen e vëmendjes ndaj çështjeve të sigurisë së komunikimeve në rrjetet 5G.

Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në infrastrukturat kritike të informacionit. Në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, janë parashikuar masa të rëndësishme për forcimin e gjendjes së sigurisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe eliminimin e efekteve të rreziqeve për Sigurinë Kombëtare, që mund të burojnë nga angazhimi i subjekteve ekonomike private dhe të huaja në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

Detyrimet ligjore të parashikuara në kreun XV të këtij ligji, janë të zbatueshme për të gjitha subjektet private qofshin me pronësi vendase apo të huaja. Këto detyrime janë shoqëruar në ligj me masa dhe sanksione që përshkallëzohen, nga gjoba deri në heqjen dhe revokimin e autorizimit mbi bazën e të cilit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Në zbatim të nenit 122, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, AKEP-i ka miratuar rregulloren nr. 37, datë 29.10.2015 "Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike".

Në lidhje me zbatimin e masave teknike e organizative, për të siguruar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, nga AKEP për rastet e shkeljeve të konstatuara, janë kryer inspektime dhe janë marrë masa.,.

Në lidhje me sigurinë kibernetike – gjatë vitit të kaluar, është kryer një vlerësim nga ekspertët e ITU-së (Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve), si dhe nga Banka Botërore. Në të dyja raportet janë dhënë disa rekomandime për Shqipërinë në lidhje me nevojën e rritjes së kapaciteteve për sigurinë kibernetike/krijimin e CIRT. Me urdhër të Kryeministrit, po punohet për hartimin e Strategjisë Kombëtare, për sigurinë kibernetike nga AKCESK-ja.

Aktivitetet e propozuara:

- Përditësimi i kërkesave ligjore e rregullatore, për sigurinë e rrjeteve Broadband në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- MIE do të bashkëpunojë me AKEP, AKCESK dhe sektorin privat për rritjen e sigurisë në telekomunikacion/rrjetet e komunikimeve;

- Do të analizohet rreziku nga zhvillimet e pritshme në rrjetet 5G dhe do të hartojë/propozojë masat e duhura ligjore/rregullatore sipas praktikës së BE-së.

Përgjegjësia:

- MIE – ndryshimet në ligjin për komunikimet elektronike sipas Kodit të Komunikimeve Elektronike të BE-së, praktikës ndërkombëtare

- AKEP

- AKCESK

Afati kohor: 2020/2021.

Forcimi i kuadrit institucional për zhvillimin *Broadband*

Për t'u siguruar që Plani Kombëtar për *Broadband* dhe aktivitetet e tij mbështetëse, të mund të implementohen si duhet, duhet forcuar kuadri institucional. Kapacitetet institucionale nëpër ministri të ndryshme dhe bashki duhet të rriten, në linjë me iniciativat shtesë të BE-së për të ndihmuar në arritjen e objektivave të shoqërisë gigabit të BE-së. Duhen ngritur zyrat kompetente për *Broadband*, të cilat do të shërbejnë si pikë e vetme kontakti në Shqipëri në nivel lokal dhe kombëtar.

Aktivitet i propozuar:

- Rritje e kapaciteteve institucionale për të siguruar implementimin efektiv të Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband.

- Ngritja e zyrës/ave kompetente për Broadband, në nivel kombëtar dhe/ose lokal sipas modeleve të mira të BE-së.

Përgjegjësia:

- MIE

- AKEP

- Pushteti vendor, bashkitë

Afati kohor: 2020–2021

Rritja e kërkesës – përdorimi i infrastrukturës NGA

Përdorimi i NGA-ve nevojitet për të arritur shoqërinë digjitale dhe reduktuar ndarjen digjitale.. Në qytetet e mëdha, përfshirë Tiranën dhe ku ka zhvillime domethënëse të NGA-ve që mundësojnë lidhje me shpejtësi shumë të lartë, shpejtësia aktuale mesatare dhe e përdorur është shumë e ulët 4–12 Mbit/s. Kjo është kryesisht për shkak të mosgatishmërisë ose paaftësisë së pajtimtarëve për të përmirësuar dhe paguar shërbim më cilësor, duke çuar kështu në përdorim të infrastrukturës së qasjes së gjeneratës së re.

Prioritet duhet t'i jepet hulumtimit të mënyrave për të stimuluar qytetarët që jetojnë në zonat me mbulim NGA, për të përdorur shpejtësi më të larta, p.sh., stimulimi i kërkesës. Për më tepër cilësia e shërbimit nuk është e ulët vetëm në zonat e largëta e rurale, por edhe në qytetet e mëdha. Shkaku i kësaj është theksuar si mbizotërimi i kabllove ajrorë që janë të ndjeshëm ndaj aksidenteve. Këtu përparësi duhet t'i kushtohet zhvendosjes së infrastrukturës në tokë.

Aktivitete që propozohen:

- Eksplorimi i mënyrave për të stimuluar qytetarët që jetojnë në zonat me mbulim NGA, për të përdorur shpejtësi më të larta, dhe rritur kërkesën për shërbime Broadband.

- Nxitja e përdorimit të shërbimeve elektronike dhe rritja e aftësive digjitale për përdorimin e tyre.

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit duke zhvendosur infrastrukturën ajrore nën tokë.

Përgjegjës:

- MIE

- AKSHI

- AKEP

- Pushteti vendor, Bashkitë

- MNOs

- Etj.

Afati kohor 2020 e në vijim

Zhvillimi i qëndrueshëm i rrjeteve *Broadband* dhe ekonomia e gjelbër

Në zhvillimin e rrjeteve *Broadband*, do të ndërmerren masa për promovimin e zhvillimeve miqësore me mjedisin, përdorimi i teknologjive alternative të ushqimit për sistemet e komunikimit si sistemet me ngrohje diellore në sitet dhe stacionet në distancë. Gjithashtu marrja e masave për reduktimin e ndotjeve mjedisore nga përdorimi i pajisjeve elektronike, do të jetë pjesë e iniciativave dhe aktiviteteve që do të inkurajohen në zbatimin e këtij plani.

Nisur nga ndjeshmëria e lartë e publikut, ku vazhdimisht ngrihen shqetësime mbi dëmet e mundshme të shkaktuara nga emetimi i valëve elektromagnetike, AKEP-i gjatë vitit 2018 dhe 2019, ka realizuar një fushatë monitorimi të nivelit të fushës elektromagnetike pranë institucioneve publike, siç janë: shkollat, kopshtet, çerdhet dhe spitalet. Gjithashtu janë kryer matje pranë antenave transmetuese në rastet kur është kërkuar nga Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet (ZMR), e cila ka administruar shqetësime mbi prezencën e antenave celulare në afërsi të banesave. AKEP-i, me qëllim informimin e publikut me rezultatet e matjeve, ka bërë publike rezultatet e matjeve në faqen elektronike, www.akep.al, gjithashtu, matjet i janë përcjellë për administrim dhe vlerësim të mëtejshëm ZMR.

Në Republikën e Shqipërisë, organet kompetente të cilat mbulojnë çështjet kryesore të rrezatimit jojonizues, janë Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi (KMR) dhe Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet (ZMR), në mbështetje të ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese". Detyrë e këtyre organeve, është hartimi i rregulloreve për përcaktimin e limiteve të rrezatimit, si dhe kryerja e studimeve për parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit publik në vendin tonë.

AKEP-i, kryen matjet e pikave transmetuese në terren, të cilat përbëjnë shqetësim, duke siguruar pajtueshmërinë me udhëzimet e publikuara nga ZMR-ja dhe Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Jojonizimet nga Rrezatimi (ICNIRP).

Rezultatet e matjeve të regjistruara deri tani, tregojnë se nivelet e rrezatimeve të emetuara nga antenat celulare, nuk e tejkalojnë pragun e sigurisë, të përcaktuar nga ZMR-ja dhe ICNIRP-ja. ZMR-ja

ka vlerësuar se asnjë instalim i testuar, nuk ka tejkaluar limitin e sigurisë së specifikuar të rrezatimit.

Megjithatë duket se ende ka vend për sqarim, kur sillet në vëmendje implementimi i teknologjisë 5G. Gjithmonë e më tepër ngrihen shqetësime mbi nivelin e rrezatimit të shtuar në mjedisin ku jetojmë dhe pasojave në shëndetin e njeriut. Për këtë arsye, AKEP, duke mbështetur misionin e organeve kompetente KMR dhe ZMR, do të vazhdojë të kryejë matje, me qëllim konstatimin e vlerave në terren, si dhe do të mbikëqyrë ndryshimet e vlerave të fushës elektromagnetike, të përftuara nga implementimi i teknologjisë 5G.

Në veçanti zhvillimet e lidhura me rrjetet 5G, krahas avantazheve për sigurimin e shërbimeve të reja, me shpejtësi e cilësi tepër të lartë në kujdesin shëndetësor, energji, transport ose arsim, kanë ngritur shqetësime lidhur me rreziqet potenciale nga rrezatimet dhe sigurinë.

Rrjetet 5G (dhe 6G në të ardhmen), do të përdorin antena shumë më të vogla në krahasim me sistemet aktuale të implementuara. Në të njëjtën kohë, antenat e reja do të arrijnë mbulim shumë më të mirë dhe shpejtësi më të lartë të lidhjes. Ato, gjithashtu, do të jenë më pak të dukshme dhe prodhojnë më pak emetime elektromagnetike. Në fakt, ato mund të krahasohen me instalimet WiFi. Për mbrojtjen nga rrezatimet dhe rritjen e sigurisë, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e shëndetit publik kundër fushave elektromagnetike, BE-ja ka miratuar disa rregulla të qarta dhe nivele të larta të mbrojtjes së shëndetit publik, kundër fushave elektromagnetike (në përputhje me Rekomandimin e Këshillit 1999/519/EC.

Rekomandimi i Këshillit 1999/519/EC, përcakton kufij të rreptë për sa i përket ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike, në përputhje me udhëzimet e vitit 1998 të Komisionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Rrezatimit Jojonizues (ICNIRP). Kjo do të thotë se: Kufijtë e BE-së për ekspozimin ndaj EMF-së të publikut të gjerë, janë gjithmonë të paktën 50 herë më të ulëta se sa provat shkencore ndërkombëtare sugjerojnë se mund të kenë ndonjë efekt në shëndet. Këto kufij nuk janë të detyrueshëm për Shtetet Anëtare të BE-së. Sidoqoftë, Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike, u referohet atyre dhe u bën thirrje Shteteve Anëtare t'i zbatojnë me rigorozitet.

Zhvillimet e rrjeteve NGN në Shqipëri, do të bëhen në përputhje me praktikën dhe standardet ndërkombëtare, udhëzimet e ICNIRP dhe vendimet e BE-së. Zgjerimi i burimeve financiare dhe fondeve për zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*.

Ndarja digjitale vazhdon normalisht, sepse tregu dështon në ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës *Broadband*, në zonat që nuk sjellin përfitime ekonomike. Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së një kuadri mbështetës për investimet private në zonat me pak interes, i cili të përcaktojë stimujt e duhur, dhe e mungesës së mekanizmave të financimit publik. Aktualisht në Shqipëri infrastruktura *Broadband*, përjashtuar zhvillimet për administratën publike, është financuar vetëm nga sektori privat. Në zonat që nuk sjellin përfitime ekonomike, është e nevojshme të ndërhyjë sektori publik dhe të ketë një kombinim të stimujve për investime me fonde publike.

Në prioritetet e MIE-s, përfshihen eliminimi i pengesave për investime në *Broadband*, në mënyrë specifike në zonat rurale. MIE ka si qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me dispozitat e Shërbimit Universal për të përfshirë zhvillimin *Broadband*.

Shqipëria ka një kuadër të përgjithshëm për ndihmën shtetërore, të miratuar me ligj në vitin 2005, por nuk ka pasur ndonjë praktikë të zbatuar për ndihmë shtetërore për zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*. Në nëntor të vitit 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka miratuar udhëzimin nr. 92 për rregullat për ndihmën shtetërore në zhvillimin e *Broadband*, bazuar në praktikën e BE-së. Në BE, një nga parimet udhëzuese është që çdo ndërhyrje shtetërore duhet të limitojë sa të mundet, rrezikun e zëvendësimit apo nxjerrjes jashtë loje të investimeve private, ndryshimin e stimujve për investime tregtare dhe shtrembërim të konkurrencës. Në rastin e zhvillimit të infrastrukturës *Broadband*, duhet të sigurohet që fondet publike të përdoren siç duhet dhe që ndihma shtetërore është plotësuese dhe nuk zëvendëson apo shtrembëron investimet e aktorëve të tregut.[24]

[24] Shiko: vendimin https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2013:

Në lidhje me prioritetetet në investime, MIE është duke punuar në kuadër të projektit për zhvillimin e *Broadband*, ku në fazën e aplikimit, është bërë një vlerësim investimi prej 48 milionë euro.

Aktivitetet e propozuara:

- Zbatimi i udhëzimit për ndihmën shtetërore për Broadband, bazuar në rregulloret e BE-së;

- Rritja e ndërgjegjësimit për skemat e ndihmës shtetërore për Broadband;

- Aplikimi i ndihmës shtetërore për Broadband në zonat dhe rastet e justifikuara.

Përgjegjësia:

- MIE

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

- AKEP;

- Institucione të tjera të lidhura me zhvillimin e Broadband në zonat rurale.

Afati kohor: 2020–2025

Rishikimi i Shërbimit Universal dhe skemat e financimit

AKEP-i, në vitin 2017, aprovoi dokumentin "Statusi i Shërbimit Universal të Komunikimeve Elektronike-2017", me përfundimin që përfshirja e aksesit *Broadband* në qëllimet e Shërbimit Universal në Shqipëri, do të ishte e parakohshme në vitin 2017 dhe në të ardhmen e afërt. Aktualisht në Shqipëri nuk është caktuar asnjë ofrues i SHU-së dhe nuk është ngritur asnjë Fond i Shërbimit Universal.[25] Në situatën e zhvillimit të *Broadband* dhe ekzistencës së ndarjes digjitale të vijueshme, del e nevojshme rishikimi i përcaktimeve për shërbimin universal si dhe skemave të financimit.

Parlamenti dhe Këshilli Evropian, më datë 18 dhjetor 2018, miratuan direktivën (EU) 2018/1972 për Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC). Kodi hyri në fuqi më datë 20 dhjetor 2018 dhe vendet anëtare, duhet ta transpozojnë atë në legjislacionet kombëtare, maksimalisht brenda dy viteve, deri në 21 dhjetor 2020.

Kuadri i ri rregullator i BE-së (më poshtë "EECC"), ka sjellë ndër të tjera ndryshime të rëndësishme në lidhje me Shërbimin Universal. Në lidhje me objektin e shërbimit universal, EECC përcakton se:

- Të gjithë konsumatorët duhet të kenë akses me çmime të përballueshme, sipas kushteve specifike të vendit anëtar, në shërbim të aksesit *Broadband* me shpejtësi adekuate dhe në shërbime të komunikimit zanor, sipas cilësisë së specifikuar në vendin përkatës, përfshirë lidhjen në rrjet nga vendndodhje fikse:

- Gjithashtu, vendet anëtare mund të konsiderojnë përballueshmërinë e shërbimeve të cituara më sipër, që nuk ofrohen nga vendndodhje fikse, në rastet kur e konsiderojnë këtë të nevojshme për të siguruar përfshirjen e plotë sociale dhe pjesëmarrjen ekonomike të konsumatorëve në shoqëri.

Aksesi funksional në internet, ka qenë pjesë e objektit të SHU-së që prej vitit 2009. Në kuadrin e ri rregullator është përfshirë Aksesi *Broandand* në internet si element i SHU. Në lidhje me sigurimin e disponibilitetit të SHU-së, për zona ku nuk ka shërbim/mbulim, Kodi përcakton që vendet anëtare kanë të drejtë të përcaktojnë një ose disa operatorë si ofrues të SHU-së, kur ajo nuk mund të sigurohet nëpërmjet praktikës normale tregtare ose nëpërmjet instrumenteve të tjerë të politikave publike si fonde të ndihmës shtetërore ose fonde të BE-së.

Bazuar në analizën e tarifave me pakicë (*retail*), vendet anëtare mund të vendosin që operatorët të ofrojnë plane tarifore në nivel kombëtar, të ndryshme nga ato të ofruara nga praktika normale komerciale, me qëllim plotësimin e nevojave të konsumatorëve me të ardhura të ulëta ose përdoruesit me nevoja specifike (të moshuarit, përdoruesit me aftësi të kufizuara, përdoruesit që jetojnë në zona të largëta). Vendet anëtare gjithashtu mund të vendosin të zgjedhin alternativën e mbështetjes direkt të konsumatorit, për shërbimet e komunikimit, të cilat mund të jenë pjesë e ndihmës sociale apo ofrimi i kuponëve, me qëllim minimizimin e shtrembërimeve të tregut.

Në lidhje me financimin e kostove neto të SHU-së, EECC përcakton se mund të realizohet nëpërmjet fondeve publike dhe/ose kontributi i industrisë/operatorëve. Ky përbën ndryshim nga kuadri rregullator aktualisht në fuqi në vendet e BE-së (dhe në Shqipëri), ku përcaktohet se kostot neto të SHU-së përballohen nga fondi i SHU-së i krijuar me kontribute të operatorëve.

025:0001:0026:EN:PDF dhe https://ec.europa.eu/regional_policy/sources/conferences/state-aid/*Broadband*_rulesexplained.pdf

[25] Shiko: ITU Questionnaire, Albania 2019

Në lidhje me shpejtësinë adekuate të aksesit *Broadband* në internet, EECC përcakton se ajo mund të caktohet nga çdo vend anëtar, sipas kushteve kombëtare dhe shpejtësisë minimale që përdoret nga shumica e konsumatorëve, duke marrë në konsideratë dhe raportet e BEREC-it për praktikat më të mira. Shpejtësia adekuate *Broadband*, duhet të mundësojë të paktën aksesin në shërbimet bazë (themelore) *online*, që përdoren nga shumica e individëve (p.sh.: e-mail, navigim në faqet web, akses në portale të gazetave apo lajmeve, shërbime të blerjeve *online*, akses në shërbimet e-Government, media sociale etj.). BEREC deri më 21 qershor 2020 do të publikojë një raport për praktikat më mira për të ndihmuar në përcaktimin e shpejtësisë adekuate të aksesit *Broadband* në internet për SHU.

Në përputhje me përcaktimet e Kodit, BEREC më 6 dhjetor 2019, ka publikuar për këshillim publik dokumentin "BEREC - *Report on Member States, best practices to support the defining of adequate internet access service*". Dokumenti përmban informacion në lidhje me praktikat e ndjekura nga vendet e BE-së, për përfshirjen e aksesit *Broadband* në SHU. Në bazë të këtij dokumenti rezulton se:

- Aksesi *Broadband* është pjesë e SHU-së (sipas kuadrit aktual ligjor/rregullator), vetëm në 9 vende anëtare të BE-së: Belgjika, Finlanda, Letonia, Kroacia, Malta, Spanja, Sllovenia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar. Shpejtësia minimale *download* e përzgjedhur për SHU-në në këto vende varion nga 1 mbps në 10 mbps dhe vetëm dy vende kanë përcaktuar dhe shpejtësi minimale për *upload*.

- Në vlerësimin për përzgjedhjen e shpejtësisë së internetit, shumica e këtyre vendeve kanë përdorur kriterin 50/80, duke vlerësuar nëse shpejtësia e caktuar për SHU-në në nivel kombëtar përdoret nga:

- të paktën 50% e të gjithë familjeve; dhe

- të paktën 80% e të gjitha familjeve me lidhje *Broadband*.

- Kritere të tjerë ta rëndësishëm, përfshijnë vlerësimin mbi disponibilitetin e pritshëm të Aksesit *Broadband*, kostot për implementimin e SHU-së, sondazhet gjeografike për mbulimin me Akses *Broadband*, impaktin në deformimin e tregut, kërkesa potenciale etj.

- Aktualisht kostot e SHU-së për broadbant, financohen nga industria në tri shtete (Sllloveni, Spanjë dhe Mbretëri e Bashkuar) dhe në tri shtete të tjera (Finlandë, Letoni dhe Suedi) është krijuar mekanizmi i financimit publik. Fondet e financimit të SHU BB, janë aktivizuar vetëm në Spanjë (fond i financuar nga industria) dhe në Letoni (fonde publike).

Shqipëria ka planifikuar rishikimin e ligjit për komunikimet elektronike me synim transpozimin e direktivës së re (EECC) të Bashkimit Evropian gjatë vitit 2021. Në këtë kuadër do të rishikohen dhe përcaktimet ligjore për Shërbimin Universal për *Broadband* dhe mekanizmat e financimit sipas praktikave të mira evropiane.

Aktivitetet e propozuara:

- Rishikimi i kuadrit ligjor e rregullator për komunikimet elektronike në lidhje me Shërbimin Universal në harmoni me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike EECC.

- Adresim i çështjes nëse Broadband duhet të përfshihet në Shërbimin Universal, bazuar në Kodin e Ri të Komunikimeve Elektronike.

- Adresim i çështjes së krijimit të Fondit për Shërbimin Universal dhe përdorimi i ndihmës shtetërore për zhvillimin e infrastrukturës Broadband;

- Vendimmarrje mbi kontributin në Fondin për Shërbimit Universal nga fonde publike dhe/ose private, si dhe mbi mekanizmin e disbursimit

Përgjegjësia:

- MIE

- AKEP

- MFE

- Operatorët e rrjetit

Afati kohor: 2021–2022

Në rishikimin e statusit të SHU-së në vitin 2017, AKEP-i vlerësoi se një ndër pengesat në përdorimin e aksesit BB, është kostoja e lartë e pajisjeve fundore (PC, laptop, tableta, *smartphone*) për shtresat e popullsisë me të ardhura të ulëta.

Të dhënat statistikore të AKEP të mbledhura nga operatorët (oferta) dhe pyetësorët e INSTAT-it për përdorimin e TIK nga familjet (kërkesa), konfirmojnë korrelacionin shumë të lartë midis numrit të familjeve me akses BB nga rrjete fikse dhe numrit të familjeve me PC. Qeveria vlerëson se krahas masave në anën e ofertës për promovimin e aksesit *Broadband*, është e nevojshme marrja e masave nga ana e kërkesës, të tilla si mbështetja e alternativave për pajisje me aparate fundore të përshtatshme për përdorimin e aksesit në internet,

të shtresave të popullsisë me të ardhura të ulëta. Pajisja e kësaj shtrese të shoqërisë me 1 PC/laptop ose tablet, do të çonte në një rritje të kërkesës për akses *Broadband* nga rrjete fikse dhe celulare, e cila e shoqëruar me ofertat e përballueshme për ketë shërbim nga operatorët e rrjeteve fikse dhe celulare, do të çonte në një rritje më të madhe të përdorimit të aksesit *Broadband* dhe gjithë përfitimeve të tjera të njohura tashmë ekonomike dhe sociale të përdorimit të internetit. Në këtë kuadër marrja e masave nga Qeveria, por edhe vetë operatorët, mund të ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim, nëpërmjet ofrimit të aparateve celulare smart në paketat tarifore me pagesa të arsyeshme mujore, siç është edhe praktika në shumë vende evropiane, përfshirë vendet e rajonit.

Menaxhimi i spektrit

Me qëllim mbështetjen e zhvillimeve të infrastrukturave *Broadband*, do të punohet për sigurimin e spektrit të nevojshëm. Lirimi i dividentit digjital 2, do të bëhet në mënyrë të kujdesshme në mënyrë që të sigurohet spektri i duhur në dispozicion të zhvillimit të mëtejshëm të rrjeteve dhe shërbimeve mobile *Broadband*, por gjithashtu të sigurohet vazhdimësi në ofrimin e shërbimeve *broadcast*.

Spektri duhet të jetë i disponueshëm dhe me çmim të përshtatshëm, për të stimuluar operatorët të ofrojnë shërbime dhe të ndërtojnë rrjete, duke përdorur teknologji të ndryshme.

Në aktivitetet e lidhura me spektrin e frekuencave, është i rëndësishëm miratimi i politikës spektrale afatmesme dhe afatgjate, rishikimi dhe përditësimi i Planit Kombëtar të Frekuencave sipas Radio-Rregulloreve Ndërkombëtare dhe Planit të Alokimeve Evropiane.

Aktivitetet e propozuara:

- Mbajtja e konsultimeve publike me palët e interesuara;

- Hartimi i një plani veprimi për lirimin e DD2 brenda vitit 2020;

- Finalizimi i lirimit të Dividentit Digjital 2;

- Analiza dhe rishikimi i tarifave të spektrit;

- Dhënia në përdorim e frekuencave të lira në 800 Mhz;

- Realizimi në kohë i ankandit për bandën 3.5 GHz.

Përgjegjësitë:

- MIE

- AMA, AKEP

- MFE

Afati kohor: 2020–2022

Në varësi të zhvillimeve teknologjike dhe kërkesave të tregut, MIE dhe AKEP-i do të bashkëpunojnë për përcaktimin e kritereve teknike dhe kushteve për mbulimin në zona rurale, për spektrin e paalokuar të brezit 800 MHz (1x10 MHz i çiftuar). Do të synohet tenderimi i këtij spektri, përpara brezit 3400-3800 MHz, ose të mund të tenderohet i kombinuar me brezin 3400-3800 MHz.

Konkurrenca e ndershme e qëndrueshme

Grupet e interesit të sektorit privat paraqesin nevojën për një kuadër rregullator, i cili bazohet në parimet e investimeve të qëndrueshme dhe konkurrencës së qëndrueshme, në mënyrë që të garantohet që praktikat e tregut nuk ndikojnë në konkurrencë.

Aktivitetet e propozuara:

- Hetim dhe adresim i praktikave antikonkurruese.

- Analizat e tregjeve përkatës për Broadband dhe marrja e masave rregulluese.

- Zbatimi i ligjeve ekzistuese mbi konkurrencën.

- Aktivitete periodike rregullator – autoriteti i konkurrencës – palë të interesuara mbi çështjet e konkurrencës në tregun e Broadband;

Përgjegjësia:

- AKEP

- Autoriteti i Konkurrencës

- MIE

Afati kohor: në vazhdimësi

Zhvillimet inovatore për ekonominë digjitale

Nxitja e zhvillimit të aplikimeve të mbështetura në rrjetet *Broadband*, si *smart city, Internet of Things* (IoT), përdorimi i inteligjencës artificiale, do të jenë pjesë e aktiviteteve dhe masave në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të *Broadband*, koordinuar dhe me aktivitetet e masat e Agjendës Digjitale.

Përmbledhja e masave sipas objektivave me aktivitetet dhe masat përkatëse, institucionet përgjegjëse dhe afatet, do të prezantohen në mënyrë të përmbledhur në shtojcë të veçantë, në fund të dokumentit.

Modelet e financimit për implementim

Shqipëria, si shumë vende të tjera në botë, ndesh disa sfida në lidhje me investimet në infrastrukturën e internetit me shpejtësi të lartë, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta, zonat pak të populluara që nuk sjellin përfitime ekonomike për investitorët privatë. Kjo del vazhdimisht në pah nga dividenti digjital. Në zonat me dendësi të lartë popullsie, kërkesa për *Broadband* dhe gatishmëria për të paguar është më e lartë, se në zonat me dendësi të ulët të popullsisë. Ky është një rast i mirë për përfitim në zona me konkurrencë të plotë, kryesisht zonat urbane, ku operatorët investojnë, në krahasim me një zonë me konkurrencë të mesme, ku aktorët duhet të mbështeten në bashkëpërdorimin e infrastrukturës dhe, së fundi, në zonat ku rrjetet kërkojnë financim shtetëror, pasi investimet private do të kishin humbje.

Qëllimi i planit për *Broadband*, është të zhvillojë strategjitë më të mira për financim, të cilat maksimizojnë mbulimin dhe sigurimin e shërbimit, për pjesën më të madhe të shqiptarëve. Kjo qasje u theksua edhe në Simpoziumin Global të Rregullatorëve të organizuar nga ITU, (ITU- GSR 2019), ku në deklaratën e 10-të të rezultateve të drejtuesve të çështjeve rregullatore CRO),[26] nënvizohet se:

1. Për të lidhur ata që nuk janë në gjendje të përfitojnë nga revolucioni digjital, nevojiten qasje të reja bashkëpunuese, përfshirë një pjesëmarrje më të gjerë të sektorit publik;

2. Financimi i zgjerimit të infrastrukturës për 49% e mbetur, nuk mund të bëhet vetëm nga operatorët e telefonisë mobile, por kërkon përpjekje të bashkërenduara nga të gjithë aktorët e ekosistemit;

3. Mjedisi rregullator duhet të sigurojë stimujt e duhur për të siguruar që mbulimi më i madh i mundshëm të mund të sigurohet në mënyrë komerciale; dhe

4. Në zonat që janë jofitimprurëse, ekuilibri i duhur duhet të arrihet midis rregullimit, përfshirjes së sektorit publik dhe forcave konkurruese të tregut.

Ekzistojnë një mori mënyrash të ndryshme për të financuar zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*. Deri më tani, në Shqipëri ndërtimi i infrastrukturës *Broadband*, ka qenë kryesisht i financuar nga sektori privat, domethënë nga operatorët e rrjetit. Në këtë fushë nuk është siguruar asnjë financim publik dhe nuk ka mekanizma të financimit publik, përveç financimit përmes ndihmës teknike ndërkombëtare. Sektori privat ka kryer investime domethënëse, megjithëse në rënie gjatë 8 viteve të fundit, të cilat arritën në vlerën totale prej 4 miliardë lekë, në vitin 2018.

Sektori privat vazhdon të angazhohet për të bërë përpara me zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*, me prioritete në investime për periudhën 2020–2025, të përqendruara në përditësimin dhe përmirësimin e të gjithë pjesëve të rrjetit, duke përfshirë *first mile, middle mile* dhe *lastmile*.

Dhe në vitet në vijim, investimet dhe kontributi i sektorit privat do të jetë domethënës, por masa mbështetëse do të merren në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian.

Për të mbështetur sektorin privat dhe për të lehtësuar investimet, AKEP-i në Strategjinë e saj dhe në Planin e Veprimit për vitin 2018, përcaktoi kushte të favorshme për investitorët, duke përfshirë:

- Rregulla të qarta dhe të qëndrueshme për zhvillimin e infrastrukturës *Broadband* dhe promovimin e investimeve në infrastrukturat e fibrave optike;
- Përshpejtim i procedurave për alokimin tek operatorët, të spektrit të përshtatshëm për shërbime *Broadband*;
- Përshpejtim i procedurave për fillimin e skemës së Shërbimit Universal; dhe
- Mbështetje e iniciativave për zhvillimin e *Broadband* në zona pa interes tregtar.

Për sa i përket sektorit publik, Shqipëria ka marrë asistencë teknike nga organizata ndërkombëtare dhe rajonale, si, për shembull, asistenca përpara aderimit nga BE-ja, në kuadër të WBIF me 48 milionë €, të parashikuara për zhvillimin e *Broadband*-it[27], studimi i parafizibilitetit i

[26] Shiko: https://www.itu.int/en/ITU-D/Conferences/CRO/Documents/CRO10/CRO2019_chairman_report.pdf

[27] Shiko: https://www.wbif.eu/wbif-projects/details?code=PRJ-ALB-DII-001&ogtitle=Regional%20*Broadband*%20Infrastructure%20Development&ogdescription=PRJ-ALB-DII-

financur nga UNDP-ja, i ndërmarrë nga Sofrecom në 2017, dhe studimi i Bankës Botërore "Balkans Digital Highway" i vitit 2017.

Gjatë viteve 2015-2017, u ngrit dhe funksionoi një fond për projektet digjitale ("Digital Albania"), i cili u përdor për të financuar aktivitetet e lidhura me e-Government. Megjithatë, pa një angazhim të shtuar financiar dhe angazhim nga sektori publik, ndarja digjitale do të vazhdojë. Tri alternativa të përgjithshme për financimin e *Broadband*-it përfshijnë: 1) Investime nga kompanitë private; 2) Partneriteti publik-privat; dhe 3) Programe financimi publike/përdorim i ndihmës shtetërore.

Për të arritur objektivat për *Broadband* të përcaktuara në Agjendën Digjitale për Evropën[28], Komisioni Evropian i ka bërë thirrje vendeve anëtare të përdorin "financimin publik në përputhje me rregullat e BE-së për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore".

Për këtë arsye, qëllimi i përdorimit të ndihmës shtetërore në Shqipëri, do të ndihmonte në arritjen e objektivave kombëtarë për *Broadband* dhe përmbushjen e vizionit për një lidhje universale me shpejtësi të lartë drejt një shoqërie informacioni, duke mbështetur përdorim shërbimesh dhe akses më të madh, cilësi më të lartë shërbimesh dhe investime konkurruese edhe në zonat jofitimprurëse.

Studimi i Sofrecom paraqet përdorimin e partneritetit publik-privat dhe të programeve të financimit publik/ndihmë shtetërore, si mekanizma financimi më të përshtatshme, për të shtrirë infrastrukturën në zonat që kanë përfitim të ulët, sipas rajoneve, si më poshtë:

- investime nga kompani private në rajonin 1, përkatësisht Tiranë, Durrës, Fier;
- partneritet publik-privat në rajonin 2, përkatësisht Elbasan, Lezhë, Berat, Vlorë;
- partneritet publik-privat dhe financim publik në rajonin 3, përkatësisht Shkodër, Korçë, Dibër, Kukës, Gjirokastër.

Bazuar në rezultatet e studimit të Sofrecom, një grant prej 0.5 milionë €, është alokuar në qershor të vitit 2018 nga WBIF, për fazat e tjera të projektit – ndërmarrja e një studimi fizibiliteti dhe krijimi i një plani zhvillimi për investime efikase dhe të zgjuara në infrastrukturës *Broadband* në të gjithë vendin. Kostoja totale e projektit, u vlerësua në shumën prej 48 milionë €. Implementimi i studimit ishte menduar të fillonte në korrik 2019, me një kohëzgjatje të pritshme prej 9 muajsh. Investimet në TIK të përfshira në projektin e përgjithshëm, do të synojnë lidhje më të mira në internet për shkollat, spitalet, institucionet publike, administratat lokale dhe familjet.

Referuar praktikës evropiane, ka një numër mjetesh dhe burimesh financimi për *Broadband*-in, që përfshijnë Financimin e Shërbimeve Universale, Grantet Shtetërore, dhe fondet e jashtme. Veçanërisht në BE, ekzistojnë mjetet e mëposhtme të financimit, në dispozicion për projektet e zhvillimit të *Broadband*-it:

- Financimi i bazuar në të ardhura: investitori merr të ardhura nga qiraja në tregun me shumicë të dark fibre, shërbimet e transmetimit dhe qiraja e infrastrukturës në tregun me pakicë ose nga tarifat e lidhjes.
- Kapitali privat dhe tregjet financiare: fonde investimesh që sigurojnë financimin e kapitalit ose të borxhit, si dhe zgjidhjet hibride, p.sh., financimi i ndërmjetëm.
- Kredi dhe obligacione bankare të mbështetura nga qeveria, të njohura gjithashtu si garanci.
- Fondet publike: të disponueshme në nivelet e qeverisë lokale, rajonale dhe kombëtare (në këtë kontekst mund të zbatohen rregullat e ndihmës shtetërore).
- Financimi publik në nivelin e BE-së përmes Fondeve Evropiane Strukturore dhe të Investimeve (ESIF).
- Financim i komunitetit nga poshtë-lart: aksionet i shiten një kompanie komunitare, e cila, ose implementon dhe drejton vetë rrjetin, ose e kryen këtë përmes furnitorëve.

Burimet e financimit për të arritur objektivat për zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*, do të jenë të ndryshme, duke përfshirë investimet nga sektori privat, që do të vijojnë të jenë kontribues kryesor për zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit, grante apo forma të tjera të financimit sipas parashikimeve ligjore.

001&ogimage=workspace://SpacesStore/bdace1e6-19dd-400a-b68a-2a5fa3e50358

[28] Shiko: https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/64/digital-agenda-for-europe, dhe Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve, *Broadband* Evropian: investime në rritjen e nxitur nga teknologjia digjitale, COM (2010) 472 final.

WBIF: Kuadri i investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor, mbështet investimet në fushën e energjisë, mjedisit, infrastrukturës së transportit dhe ato sociale, si dhe projekte të zhvillimit të infrastrukturës nga sektori privat. Sektori digjital ka mundësi që gjithashtu të përfitojë me grante të ngjashme në programet e pritshme të BE-së, për periudhën 2021–2027.

Financimet publike nga njësitë e qeverisjes vendore në zhvillimin e infrastrukturës pasive në zotërim të tyre, ose për zhvillimin e projekteve të caktuara për sigurimin e mbulimit me *Broadband* në zonat respektive dhe sipas modeleve të vendeve evropiane, do të jenë një nga format e financimit për realizimin e objektivave të vendosur.

Investimet në zhvillimin e infrastrukturës pasive në rrugët kombëtare, për tubacionet që përdoren për shtrirjen e fibrës optike, do të vijojnë nga ARRSH-ja, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për zhvillimin e rrjeteve *Broadband*. Nxitja e sinergjisë në projektet e utiliteteve, si: energji, ujë, gaz, transport, do të jetë, gjithashtu, një mundësi për reduktimin e kostove për zhvillimin e infrastrukturës *Broadband*.

Koordinimi i aktiviteteve për zhvillimet rajonale, të turizmit, bujqësisë apo zhvillimit rural, me zhvillimin e infrastrukturës digjitale *Broadband*, gjithashtu do të jetë një mënyrë për adresimin e nevojave për financim në mbulimin e zonave të bardha ose gri. Ministria përgjegjëse e linjës dhe institucionet e tjera të përfshira, do të angazhohen për gjetjen e mënyrave të mbështetjes për realizimin e zhvillimit të infrastrukturës digjitale. Rezultatet përfundimtare të studimit të fizibilitetit, do të ofrojnë rekomandime në lidhje me financimin dhe mekanizmat e përshtatshëm të financimit për Shqipërinë, për të arritur objektivat e saj për *Broadband*-in. Një përmbledhje e mekanizmave të ndryshëm të financimit të zbatuara në vende të ndryshme, është dhënë në shtojcën bashkëlidhur.

Mekanizmat e implementimit dhe monitorimi

Për sa i përket mekanizmit të implementimit të Planit Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband*-it, një i tillë u krijua me Planin Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband*-it të vitit 2013. Nga ajo periudhë kanë ndodhur disa ndryshime në nivelin institucional, të cilat kanë ndikuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e institucioneve dhe agjencive të ndryshme.

Në nivel vendimmarrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), është institucioni përgjegjës për zhvillimin e infrastrukturës *Broadband* dhe zbatimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband*-it.

Mbi bazën e urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar", janë krijuar Grupet e Menaxhimit të Integruar të Programeve ("GMIP") dhe Komitetet Drejtuese Strategjike, për të promovuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, agjencive të ndryshme qeveritare si edhe politikat dhe aktivitetet korresponduese. Komiteti Drejtues Strategjik "Ndërlidhja", që drejtohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka në përbërje grupin tematik për telekomunikacionin dhe *Broadband*, që drejtohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të AKEP-it, institucioneve të tjera të përfshira në proces.

Një ndryshim i dytë në fushën e TIK, ka të bëjë me riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). AKSHI është përgjegjës për shoqërinë e informacionit, eGov dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve të Qeverisë në fushën e teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.[29]

Nga pikëpamja operacionale, "Grupi Tematik për Telekomunikacion dhe *Broadband*" nën KDS "Ndërlidhja", do të ndjekë procesin e vazhdueshëm të implementimit dhe arritjes së objektivave për zhvillimin *Broadband*, bazuar në Planin Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband*-it, dhe do të shërbejë si njësi koordinuese e zbatimit për të gjitha aktivitetet përkatëse, si dhe koordinimin e palëve të interesuara. Propozuar si një aktivitet kryesor, për periudhën 2020–2025, dhe në përputhje me rekomandimet e BE-së, do të krijohen zyrat kompetente për *Broadband*-in, për të mbështetur "Grupin Tematik për Telekomunikacion dhe *Broadband*", të cilat do të shërbejnë si pika të vetme kontakti për ekzekutimin e detyrave dhe projekteve konkrete.

[29] Detyrat dhe roli kryesor i AKSHI-t përcaktohen në bazë të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".

Në aspektet e zhvillimit dhe në veçanti të nxitjes së kërkesës për *Broadband*, përmes rritjes së përdorimit të shërbimeve publike, do të koordinohet me AKSHI-n. Ministritë, agjencitë, departamentet dhe autoritetet e tjera përkatëse do të vazhdojnë me rolet e tyre, për aq kohë sa nuk kanë ndryshuar, për sa i përket zbatimit të detyrave dhe objektivave që u janë caktuar atyre në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës *Broadband* nën Planin Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband*-it.

Ministritë dhe administratat publike lokale do të vazhdojnë të bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe sektorin privat. Çdo ministri, institucion dhe agjenci përkatëse do të raportojë periodikisht në Grupin Tematik për Telekomunikacion dhe *Broadband*, në kuadër të implementimit të aktiviteteve të tyre.

Monitorimi dhe vlerësimi i progresit, drejt arritjes së objektivave, do të bazohet në raporte periodike dhe indikatorë kryesorë statistikorë, të paraqitur nga të gjithë aktorët përkatës.

Indikatorët për monitorimin e zhvillimit të *Broadband* në Shqipëri përfshijnë:

- Aksesin në rrjete/shërbime *Broadband* (numri i pajtimtarëve dhe përdoruesve, shkalla e penetrimit të *Broadband*-it dhe shkalla e rritjes së penetrimit).
- Zona e mbulimit me *Broadband*.
- Konkurrenca (HHI në tregjet me pakicë dhe shumicë).
- Nivelet e çmimeve të shërbimeve *Broadband* (tarifat për *Broadband* fiks dhe mobile).
- Cilësia e Shërbimeve *Broadband* (numri i ankesave dhe vlerësimeve të klientëve).
- Numri i shërbimeve dhe aplikacioneve *Broadband* dhe përdorimi i tyre (treguesit janë rritja e të dhënave të shkarkuara nga interneti, numri i shërbimeve dhe aplikacioneve në dispozicion, llojet e shkarkimeve)
- Përdorimi i *Broadband* në edukim dhe fushën kërkimore (do të matet me përdorimin e *Broadband*-it në shkolla dhe sektorët e formimit profesional).
- Përdorimi i *Broadband* në shëndetësi (përdorimi i *Broadband*-it nga praktikuesit, specialistët dhe spitalet).
- Përdorimi i *Broadband* në ofrimin e shërbimeve qeveritare (do të matet nga përdorimi i *Broadband*-it nga qeveria dhe aksesi i përdoruesve të institucioneve në faqet zyrtare të internetit).
- Përdorimi i *Broadband* nga biznesi (nga numri i punonjësve që përdorin *Broadband*-in).
- Përdorimi i *Broadband* në komunitet (popullsi).

Për monitorimin e përgjithshëm të zhvillimit të ekonomisë dhe shoqërisë digjitale, do të përdoret indeksi DESI[30], sipas modelit të zhvilluar nga BE-ja. Për llogaritjen e këtij indeksi do të punohet në bashkëpunim me INSTAT-in, AKEP-in, AKSHI-n dhe institucione të tjera të lidhura me nënindikatorët e përfshirë në këtë tregues.

Kostot e implementimit

Studimi i fizibilitetit nga WBIF, përmes raportit të modelit të kostove për zhvillimin e *Broadband*, ka detajuar kostot e implementimit të infrastrukturës *Broadband*, me qëllim arritjen e shoqërisë gigabit. Raporti jep katër skenarë të zhvillimit dhe një vlerësim të kostos për secilin prej tyre për një periudhë 20-vjeçare. Për secilin nga skenarët janë llogaritur vlerat për investimet në CAPEX dhe kostot e OPEX që variojnë nga 533 milionë euro në 960 milionë euro për CAPEX, dhe nga 253 milionë euro në 323 milionë euro për OPEX sipas skenarëve të ndryshëm si më poshtë:

Skenari 1: teknologjia GPON, rrjet nëntokësor FTTH për gjithë territorin e Shqipërisë

Skenari 2: teknologjia GPON, me rrjet të kombinuar nëntokësor dhe ajror me FTTH për të gjithë territorin e Shqipërisë (Përqindja e rrjetit ajror me Fibër: 15% në zonën urbane dhe 85% në zonën rurale)

Skenari 3: teknologji e miksuar GPON me rrjet nëntokësor dhe ajror me FTTH dhe LTE Fixed Wireless Access Network për të gjithë territorin e Shqipërisë (10% e popullsisë e mbuluar me fiks wireless akses (FWA) dhe 90% e popullsisë me rrjet nëntokësor/ajror me FTTH, teknologjia GPON (duke përdorur përqindjet e skenarit të dytë).

Skenari 4: zgjidhje e kombinuar, miks GPON rrjet nëntokësor/ajror FTTH për gjithë territorin duke përjashtuar zonat ku nuk ka prezencë të shkollave, qendrave shëndetësore, ndërtesa publike (*main socio-economic drivers*), duke përdorur parametra të ngjashëm për kombinimin si në skenarin e dytë.

[30] https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/digital-economy-and-society-index-desi-2019

SHTOJCAT

SHTOJCË 1
LISTA ME ZHVILLIMET KRYESORE LIGJORE DHE RREGULLATORE PËR *BROADBAND*-IN NGA VITI 2013

- "Plani për Shërbimin Universal në fushën e Komunikimeve Elektronike 2013–2016"[31] dhe vendimi nr. 12, datë 19.4.2017 që miraton dokumentin "Statusi i Shërbimit Universal të Komunikimeve Elektronike 2017"

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 8.4.2015 "Për disa ndryshime në Planin Kombëtar të *Broadband*-it" të miratuar në vitin 2013, që shërbeu për heqjen e kufizimeve teknologjike për përdorimin e frekuencave dhe nxiti ofrimin e shërbimeve 4G.

- Alokimi i spektrit dhe dhënie e bandave të frekuencave 790–862 MHz për komunikimet mobile dhe disponibiliteti i bandës së frekuencave 694–790 MHz për komunikimet mobile deri në 2020.

- Vendimi i AKEP-it nr. 2648, datë 3.12.2015, i cili miraton zonat me densitet të ulët të popullsisë për t'i mbuluar ato me shërbime *Broadband* dhe zonat për përmirësim të shërbimit.

- Një seri dokumentesh SMP si analiza e tregut LLU, Aksesi *Broadband* (*bitstream*) dhe linjat me qira.

- Rregullorja datë 10.9.2015, "Rregullat për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike".

- Rregullorja nr. 37, datë 19.10.2015 "Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike" .

- VKM-ja nr. 851, datë 7.12.2016, "Për kalimin e të dhënave mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike te bashkitë".

- Miratim Planit Kombëtar të Frekuencave me anë të VKM-së nr. 277, datë 29.3.2017.

- Rregullore nr.47 "Mbi implementimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm".

- VKM-ja nr. 222, datë 26.4.2018 "Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit", së bashku me legjislacionin dytësor të nevojshëm.

- Urdhri nr.157, datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ ndërsektorial të integruar";

- AKEP-i është koordinuar me rregullatorët në sektorin e energjisë elektrike për të marrë informacion mbi infrastrukturën e energjisë elektrike e cila mund të përdoret për *Broadband*.

- AKEP-i është koordinuar me Ministrinë/Qeverinë, për të përgatitur aktet nënligjore në zbatim të ligjit për promovimin e *Broadband*-it të shpejtë dhe ultra të shpejtë, për të lehtësuar procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit për punimet civile.

- AKEP-i ka bashkëpunuar me autoritetet vendore, për dhënien e lejeve për operatorët, për të zhvilluar infrastrukturën *Broadband*, veçanërisht në zonat e pambuluara me shërbime fiks dhe mobile (Plani i Veprimit i AKEP-it 2019).

- MIE në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm dhe palët e interesuara, ka hartuar një udhërrëfyes dhe strategji për 5G për Shqipërinë "Raporti i Ekspertit: Strategjia 5G për Shqipërinë – Udhërrëfyesi për gjeneratën 5G të komunikimeve mobile në Shqipëri", korrik 2019.

[31] Shiko: AKEP Steering Board Decision No.2324, dated 28.06.2013

Vështrim i përgjithshëm për progresin, lidhur me objektivat e përgjithshëm dhe qëllimet e 2013–2020

Objektivat e Përgjithshme	Ralizimet	Mos Ralizimet	Qëllimet 2013-2020	Ralizimet	Mos Ralizimet
Përmirsimet dhe zhvillimi i mëtejshëm i Broadband	√		Dyfishimi I numrit të familjeve dhe kompanive të cilat kanë akses në broadband jo më vonë se 2017	√	
Rritja e penetrimit të Broadband	√		100% e shkollave me të paktën lidhje në internet broadband në çdo klasë		X
Siguron Internet me shpetësi të lart dhe siguri në nivel lokale, rajonal dhe kombëtar, përfshirë zonat rurale dhe të largëta		X	100% e universiteteve me lidhje në internet broadband me shpejtësi të lart		X
Rritja e konkurrencës dhe çmime të ulta	√		100% e zyrave postare të ofrojnë të paktën një lidhje interneti broadband për qytetarët		X
Rritja e cilësisë së shërbimit	Pjesore		100% e qëndrave shëndetësore dhe spitaleve me të paktë një lidhje interneti broadband		X
Zgjerimi i numrit të e-shërbimeve të disponueshme për shtetasit Shqiptarë dhe digjitalizimin e të gjitha shërbimeve	√		Lehtësimi aksesit për transmetimin me shpejtësi të lart, me të paktë 100 Mbps për 50% të familjeve dhe të paktë 30 Mbps për të gjith Shqiptarët		X
Rritja e ndërgjegjësimit e shoqërisë, përfshirë njerzit me aktësi të kufizuara, lidhur me benefitet që dalin nga përdorimin i broadband	√				

Burimi: Nga analiza në kuadër të rishikimit të Planit Kombëtar të Broadband

SHTOJCË 2
ZHVILLIMET E FUNDIT NË BE NË LIDHJE ME *BROADBAND* DHE SHOQËRINË GIGABIT

Strategjia e Komisionit mbi Ndërlidhjen për një Shoqëri Gigabit Evropiane, miratuar në Shtator 2016, paraqet një vizion të Evropës ku disponueshmëria dhe marrja e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë bën të mundur përdorimin gjerësisht të produkteve, shërbimeve dhe aplikacioneve në tregun e vetëm digjital.

Ky vizion mbështetet në tre objektiva strategjikë kryesorë për vitin 2025:
- Ndërlidhje Gigabit për gjithë drejtuesit kryesorë socialë dhe ekonomikë.
- Mbulim 5G i pandërprerë për të gjitha zonat urbane dhe rrugët kryesore të transportit tokësor, dhe
- Akses në ndërlidhje me të paktën 100 Mbps për të gjithë familjet evropiane.

Objektivat strategjikë konfirmojnë dhe janë ngritur mbi objektivat e mëparshëm për *Broadband* të vitit 2020, të cilat përfshijnë qëllime për infrastrukturë dhe shërbime interneti me shpejtësi të lartë si më poshtë:
- Mbulimi me 30 Mbits ose më shumë, për të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE);
- 50 përqind e familjeve të kenë abonime me shpejtësi 100 Mbits ose më të lartë.
- Për më tepër, duhet që 5G të jetë e disponueshme në të paktën një qytet kryesor në secilin Vendet Anëtar, deri më vitin 2020.

Komisioni ka ndërmarrë një seri iniciativash plotësuese, për të ndihmuar në arritjen e këtyre objektivave: Kodi i Ri Evropian i Komunikimeve Elektronike, i propozuar nga Komisioni dhe dakordësuar nga Parlamenti Evropian e Këshilli në fund të vitit 2018, do t'i japi shtysë investimeve në rrjetet me kapacitet shumë të lartë në BE, duke përfshirë zonat rurale dhe të largëta.
Veprimet e mëtejshme përfshijnë: një Plan Veprimi 5G; një iniciativë për të sjellë akses pa pagesë në lidhjen WiFi (WiFi4EU) në zonat publike, si parqet, bibliotekat dhe sheshet; Fondin *Broadband* për të lidhur Evropën që mbështet financimin e infrastrukturës së rrjetit *Broadband*; Connecting Europe Facility (CEF), që nxit aplikimin dhe modernizimin e rrjeteve *Broadband*. Digjital CEF, si pjesë e buxhetit 2021-2027 të BE-së, do të duhet të financojë infrastrukturën strategjike të lidhjes digjitale, me 3 miliardë EURO dhe do të vendoset nga fundi i vitit 2019. Një iniciativë mbi hartëzimin e të dhënave *Broadband*, do të ofrojë një aplikacion *online* interaktiv për të vizualizuar disponueshmërinë *Broadband* dhe cilësinë e shërbimit në shkallë Evropiane.

Rregullat e Komisionit për ndihmën shtetërore lejojnë përdorimin e fondeve publike për investime në rrjetet *Broadband*, kur këto investime sjellin përmirësim të konsiderueshëm të rrjeteve ekzistuese (siç quhet edhe "hapi i ndryshimit").

Kuadri Financiar Shumëvjeçar (MFF), reflekton prioritetet e investimeve të Komisionit në infrastrukturën strategjike. MFF është rregulluar për vitin 2019 dhe është bërë një propozim buxheti afatgjatë dhe modern për vitin 2021-2027.

Burimi:https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/Broadband-europe

SHTOJCË 3
MODELE TË NDRYSHME TË FINANCIMIT TË PËRDORUR PËR *BROADBAND*

Modelet e financimit përcaktojnë sesi mund të financohet nga fondet publike dhe investimet private, vendosja e rrjeteve *Broadband*. Ndërhyrja shtetërore duhet të fokusohet në reduktimin e kostove të investimeve dhe, kur është e nevojshme, duhet të sigurohen fonde publike brenda kornizës së politikave të strategjive kombëtare, duke siguruar që investimet private nuk zhvendosen.

Modelet e investimeve paraqesin mundësi përfshirjeje, veçanërisht të vlefshme për një autoritet publik që angazhohet në zhvillimin e *Broadband*-it rajonal. Zgjedhja e një modeli bazohet në situatën ekonomike. Mund të identifikohen katër modele investimesh:

- **Modeli i rrjetit bashkiak drejtuar nga shteti (autoritetet publike)/Modeli i DBO-s publike**: Në këtë model, autoriteti publik ndërton një rrjet *Broadband* në bashki, qark ose rajon (DBO i referohet modelimit, ndërtimit dhe operimit). Vendosja drejtohet dhe kontrollohet drejtpërdrejt nga autoriteti publik. Ky model është aplikuar me sukses në Argjentinë, projekti RAIN i Lituanisë dhe Katar, QNBN.

Modeli i rrjetit bashkiak drejtuar nga privati: Në këtë model, autoriteti publik siguron ndërtimin dhe funksionimin e një Rrjeti *Broadband* në bashki, qark ose rajon nga një aktor privat (i referuar gjithashtu si modeli i dhënies së burimeve publike ose koncesion). Firma private e kontraktuar në përgjithësi ndërton një rrjet të hapur, të barabartë për të gjithë operatorët, mbi të cilin ofruesit e shërbimeve konkurruese mund të ofrojnë shërbimet e tyre për të gjithë përdoruesit fundorë. Autoriteti publik mban pronësinë e infrastrukturës pasive por kontrata e funksionimit me firmën e jashtme është tipike në formën e së drejtës së padepërtueshme të përdorimit (IRU) p.sh. për 20 vjet.

- **Modeli i projektimit, ndërtimit dhe operimit nga privati (DBO)**: një organizatë e sektorit privat merr fonde publike (shpesh një grant), për ta ndihmuar atë në vendosjen e një rrjeti që ofron akses të hapur me shumicë. Sektori publik nuk ka asnjë rol në pronësinë ose drejtimin e rrjetit. Ky model është përdorur me sukses në Projektin e *Broadband*-it Rural të Republikës Dominikane, në Malajzi (NBI), në Projektin e Zhvillimit të infrastrukturës TIK të Mongolisë në bashkëpunim me qeverinë e Mongolisë, qeverinë e Japonisë dhe Bankën Botërore, në programin USF të *Broadband* në Pakistanit, në Projektin e Shërbimit Universal të Arabisë Saudite dhe në lidhje me NGN BN të Singaporit.

- **Modeli nga poshtë–lart ose *Broadband* i komunitetit lokal**: Në këtë model, investimi *Broadband*, kryhet si nismë private nga banorët lokalë (qasja nga poshtë–lart). Projekte të tilla në përgjithësi kanë qenë shumë të suksesshëm në drejtimin e nivelit të marrjes midis përdoruesve fundorë dhe në ndërtimin e rasteve të qëndrueshme financiarisht. Shkalla e konkurrencës ndryshon, midis projekteve që përdorin një model biznesi të rrjetit të hapur me nivele të mira të konkurrencës, ndaj të tjerëve që veprojnë si operatorë të integruar vertikalisht ose prokurojnë shërbime nga një operator për disa vite. Sektori publik nuk ka asnjë rol në zotërimin ose drejtimin e infrastrukturës, por ai mund të mbështesë bashkëfinancimin dhe dhënien e së drejtës së kalimit (RoW), rregullimin dhe koordinimin me zhvillimet e tjera të infrastrukturës dhe aksesin në infrastrukturën publike dhe "points of presence", për të siguruar lidhjet backhaul. Autoritetet publike gjithashtu mund të ndihmojnë në krijimin e kushteve të drejta për të gjithë operatorët që kërkojnë qasje në infrastrukturë. Shembuj të suksesshëm përfshijnë nisma private në Mbretërinë e Bashkuar, Finlandë (eRegio në Karelia Veriore), Suedi (Programi i Zhvillimit Rural) dhe në Holandë (projekti OnsNet në Nuenen).

- **Modeli i subvencionit të operatorit/financimi i hendekut**: Në këtë model, autoritetet publike nuk janë të përfshira drejtpërdrejtë në projektet e zhvillimit të *Broadband*-it të rajonit, por subvencionojnë një aktor të tregut, për të përmirësuar infrastrukturën e tij. Operatorët aktualë të telekomunikacionit dhe ofruesit e mëdhenj alternativë, zakonisht zotërojnë infrastrukturën pasive, pajisje aktive dhe ofrojnë shërbime në një model të integruar vertikalisht tek përdoruesit fundorë. Autoriteti publik financon hendekun midis asaj që është komercialisht e zbatueshme dhe mbulimit që autoriteti publik synon të arrijë. Financimi ofrohet si një grant për një ose më shumë operatorë privatë. Ky model është zbatuar me sukses në Gjermani.

Janë një numër mjetesh dhe burimesh financimi për *Broadband*-in, që përfshijnë financimin e shërbimeve universale, grantet shtetërore, dhe fondet e jashtme. Veçanërisht në BE, ekzistojnë mjetet e mëposhtme të financimit në dispozicion për projektet e zhvillimit të *Broadband*-it:

- **Financimi i bazuar në të ardhura**: investitori merr të ardhura nga qiraja në tregun me shumicë të dark fibre, shërbimet e transmetimit dhe qiraja e infrastrukturës në tregun me pakicë ose nga tarifat e lidhjes.

- **Kapitali privat dhe tregjet financiare**: fonde investimesh që sigurojnë financimin e kapitalit ose të borxhit, si dhe zgjidhjet hibride, p.sh., financimi i ndërmjetëm.

- **Kredi dhe obligacione bankare të mbështetura nga qeveria**, të njohura gjithashtu si garanci.

- **Fondet publike:** të disponueshme në nivelet e qeverisë lokale, rajonale dhe kombëtare (në këtë kontekst mund të zbatohen rregullat e ndihmës shtetërore).

- **Financimi publik në nivelin e BE-së**, përmes fondeve evropiane strukturore dhe të investimeve (ESIF).

- **Financim i komunitetit nga poshtë–lart**: aksionet i shiten një kompanie komunitare, e cila, ose implementon dhe drejton vetë rrjetin, ose e kryen këtë përmes furnitorëve.

Shiko: ITU "Developing Successful Public-Private Partnerships To Foster Investment In Universal *Broadband* Networks" në https://www.itu.int/dms_pub/itu-d/opb/pref/D-PREF-THEM.17-2013-PDF-E.pdf, dhe EU https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/financing-*Broadband*-project, https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/investment-models

VENDIM
Nr. 89, datë 22.5.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "MP-HEC" SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 74, DATË 22.4.2020, "MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 25.11.2019, 'MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'MP-HEC' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC 'NIÇË', ME KAPACITET TË INSTALUAR 2270'"

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 140, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", nenit 16, të "Rregullores për organizimin, procedurat dhe funksionimin e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.5.2020, mbasi shqyrtoi dhe u njoh me propozimet e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe asaj të Çështjeve Ligjore në relacionin e përgatitur "Mbi kërkesën e Shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., për rishikimin vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 22.4.2020, 'Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Niçë' me kapacitet të instaluar 2270'", si dhe infon shtesë të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 74, datë 22.4.2020, ka vendosur:

1. Miratimin e disa ndryshimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, si më poshtë:

a) Pika 1, germa "b" ndryshon: Shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., të depozitojë në ERE "Lejen e shfrytëzimit të ujit" të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), para fillimit të operimit të veprës.

b) Pika 1, germa "c", shfuqizohet.

- Vendimmarrja e mësipërme është marrë në kushtet kur shoqëria "MP-HEC" sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me kërkesën e datës 14.3.2020, protokolluar në ERE me nr. 289/10 prot., për shtyrjen me 6 muaj të afatit të dorëzimit të miratimit të prurjes së re të ujit, në përputhje me projektin e zbatimit të përmirësuar, të miratuar me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018. Sa më sipër, në konstatim të situatës së krijuar për shkak të kufizimeve të vendosura për të parandaluar përhapjen e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19. Me shkresën e datës 14.3.2020, protokolluar në ERE me nr. 289/10 prot., datë 30.3.2020, shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën nr. 922 prot., datë 24.2.2020, "Për VNM-të paraprake" të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, drejtuar shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., për kapacitetin 2270 kw, në bazë të miratimit të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC "Niçë", nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me nr. 11965 prot., datë 13.12.2018.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, nga ana e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., është depozituar në ERE me komunikimin elektronik të datës 22.04.2020, nr. 656/3 prot., kërkesa për rishikimin e vendimit të Bordit nr. 74, datë 22.4.2020, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, "Mbi licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Niçë', me kapacitet të instaluar 2270 kw".

- Në vijim të kësaj kërkese, ERE, me shkresën nr. 656/2 prot., datë 29.4.2020, në zbatim të parashikimeve të nenit 62, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", iu drejtua shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., duke i kërkuar saktësimin e objektit të kërkesës për rishikim brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, saktësime të cilat lidheshin kryesisht me afatin minimal 6 muaj, për të cilin shoqëria kërkon shtyrjen, në një kohë kur ERE ka pranuar kërkesën e saj për shtyrjen e afatit (minimal) të plotësimit të këtij kushti mbi 6 muaj.

- Shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., me shkresën e datës 1.5.2020, protokolluar në ERE me nr. 656/3, datë 2.5.2020, ka përcjellë saktësimet e shpjegimet në lidhje me objektin e kërkesës së saj për rishikim,

duke kërkuar rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 74, datë 22.4.2020, sipas së cilës ndër të tjera ka propozuar: Lënien e një afati 6-mujor të licencuarit, për dorëzimin e lejes së shfrytëzimit të ujit, të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pa kushtëzuar operimin e HEC "Niçë".

Kushtet procedurale të rishikimit të vendimit të Bordit të ERE-s:

- Në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, por edhe në nenin 16, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s" të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, përcaktohet se: Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

Në lidhje me sa më sipër konstatojmë se:

- Shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., është palë e përfshirë në procedurë sepse ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në këtë procedurë administrative, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", duke qenë subjekti për shkak të të cilit ka filluar procedura administrative.

- Kërkesa e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., është depozituar në ERE brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

- Shoqëria "MP-HEC" sh.p.k. ka përcjellë, në cilësinë e provës, shpjegime si më poshtë:

Shoqëria pretendon se ndodhet në kushtet e forcës madhore në kuptim të përkufizimeve të parashikuara në pikën 1.6, të kushteve të licencës së prodhimit.

- Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se, referenca e mësipërme lidhet me kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar, siç është parashikuar në kushtet e licencës. Ndërkohë që, kushtet për plotësimin e të cilave shoqëria kërkon shtyrjen e afateve, lidhen me procedurën dhe procesin e licencimit, në përfundim të të cilit rezultoi se shoqëria i përmbushte kushtet për t'u licencuar por nuk i përmbushte tërësisht kushtet për të ushtruar aktivitetin. Detyrimi për paraqitjen në Entin Rregullator të Energjisë (ERE) të lejes së shfrytëzimit të ujit të rinovuar, në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), është kusht i licencimit të subjektit dhe jo kusht i licencës.

- Shoqëria pretendon se mungesa e "Lejes së shfrytëzimit të ujit", nuk mund ta penalizojë atë për të mos filluar operimin e saj me kapacitetin prej 990 kw, kapacitet për të cilin shoqëria thotë se disponon dhe ka dorëzuar në ERE "Lejen e shfrytëzimit të ujit".

- Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se:

- Sipas Kontratës së Koncesionit nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol., datë 2.2.2009, "Për ndërtimin e HEC "Niçë", kapaciteti i instaluar i HEC "Niçë" është 600 kw;

- Sipas projektit të zbatimit të përmirësuar dhe të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018, në vijim të oponencës teknike të AKBN-së nr. 5032/1 prot., datë 10.6.2015, kapaciteti i instaluar është 2270 kw.

- Sipas lejes mjedisore, leja është dhënë për kapacitetin e instaluar 990.72 kw. Lidhja me rrjetin është miratuar për kapacitetin e instaluar prej 2340 kw (kapacitet brenda 10% të lejuar në licencën e prodhimit).

- Në kuptim të nenit 4.1.5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215, datë 20.12.2019, parashikohet se: Nuk jepet licencë për operimin e një linje direkte në transmetim apo shpërndarje, për prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 mw.

- Kërkuesi ka sqaruar Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, AMBU, dhe tashmë në këtë kërkesë sqaron edhe për ERE-n se, në skemën e shfrytëzimit nuk është shtuar një përrua, por vetëm kanë ndryshuar parametrat hidrikë të autorizimit dhe lejes së dhënë.

- Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se: AMBU-ja (Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore) me shkresën nr. 1272/1 prot., datë 3.11.2019, shprehet se: Për shkak të ndryshimeve në projektin e zbatimit të miratuar nga AKBN-ja, për HEC "Niçë", miratimi në parim nr. 26, datë

3.4.2007, si dhe leja e përdorimit të burimit ujor nr. VI/5, datë 17.2.2010, e Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin, për HEC "Niçë", kanë nevojë për rishikim, duke qenë se:

1. Shtohet një përrua në skemën e shfrytëzimit, i cili nuk ka qenë pjesë e autorizimit dhe lejes për të cilat organet e menaxhimit të burimeve ujore kanë marrë vendim.

2. Ndryshojnë parametrat hidrikë të autorizimit dhe lejes së dhënë.

Në vijim, shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., duhet të aplikojë në Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin–Seman, duke plotësuar dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas VKM-së së sipërcituar.

- Në lidhje me legjitimimin e kërkesës për rishikim, në kushtet e konstatimit të gabimeve materiale të konstatuara, rezulton se shoqëria, me shkresën e datës 14.3.2020, protokolluar në ERE me nr. 289/10 prot., datë 30.3.2020, i është drejtuar Entit Rregullator të Energjisë (ERE), me kërkesën për shtyrjen me 6 muaj të afatit të dorëzimit të miratimit të prurjes së re të ujit, në përputhje me projektin e zbatimit të përmirësuar, të miratuar me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 11965/1, datë 13.12.2018.

Sa më sipër, në kuptim të vendimmarrjes së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 74,datë 22.4.2020, ERE ka vepruar në vlerësim të kërkesës dhe rrethanave të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë, duke mos vendosur kufizimin e afatit me 6 muaj, por duke e lënë atë të pakufizuar, deri në krijimin e rrethanave për plotësimin e kushtit nga shoqëria. Sa më sipër, përmbush kërkesën e shoqërisë.

- Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për shkaktimin e dëmeve financiare për shkak të vendimeve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 187, datë 25.11.2019, si dhe nr. 74, datë 22.4.2020, konstatojmë se, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së pestë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të licencave. Në kuptim të sa më sipër, kufizimi i së drejtës së ushtrimit të një prej aktiviteteve të parashikuara në ligjin e sipërcituar, me përmbushjen e kushteve të parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, janë jo vetëm e drejtë, por detyrim ligjor i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), qëndrim ky i mbajtur edhe në mbledhjen vendimmarrëse të Bordit, të datës 25.11.2019.

- Në lidhje me pretendimin e kërkuesit, se vendimi i Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, në zbatim të nenit 117, pika 1 të Kushtetutës, si dhe nenit 104, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ka hyrë në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare, pra më 16.12.2019, pavarësisht se në dispozitivin e vendimit parashikohet se hyn në fuqi menjëherë, sqarojmë se: Në nenin 117, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet se: Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.

- "Kodi i Procedurave Administrative" në nenin 3, pika 1 dhe 2 të tij, identifikon ndryshimin midis aktit administrativ dhe aktit normativ. Akti administrativ shpreh vullnetin e organit publik për të ndikuar apo për të sjellë pasoja në mënyrë të drejtpërdrejtë në situatën/pozitën juridike të atij të cilit i drejtohet. Sa më sipër, në ndryshim nga akti normativ, i cili parashikon një masë e cila i drejtohet personave të papërcaktuar në funksion të një gjendjeje të papërcaktuar dhe vendos një apo më shumë rregulla të detyrueshme për zbatim nga një apo më shumë subjekte të së drejtës. Gjithashtu në kuptim të nenit 3, pika 6, të Kodit të Procedurave Administrative, janë përkufizuar në mënyrë të qartë e mjaftueshëm shteruese, organet, që në kuptim të këtij ligji, konsiderohen organe publike, duke bërë dallimin nga ato qendrore, në entet publike që kryejnë veprimtari administrative.

- Për sa më sipër, vendimet e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 187, datë 25.11.2019, dhe nr. 74, datë 22.4.2020, janë akte administrative individuale, të nxjerra nga Enti Publik ERE, dhe në kuptim të parashikimeve të nenit 104, pika 2, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kanë hyrë në fuqi me njoftimin e përmbajtjes së aktit, palëve.

- Në lidhje me pretendimin e kërkuesit, të cilat lidhen me shpjegime mbi vendimmarrjen e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 187, datë 25.11.2019, konstatojmë se janë përtej objektit

të kërkesës dhe përtej afateve ligjore për rishikimin e këtij vendimi, e si të tilla nuk afektojnë vendimmarrjen e Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 74, datë 22.4.2020, dhe as këtë kërkesë për rishikim të vendimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 74, datë 22.4.2020. Shoqëria është bërë me dije shkresërisht, në lidhje me qëndrimin e ERE-s për sa më sipër.

- ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 656/4 prot., datë 15.5.2020, duke i kërkuar që të saktësojë datën e plotësimit të afatit 6-mujor, kohë në të cilën angazhohet të plotësojë dokumentacionin përkatës.

- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e datës 19.5.2020, protokolluar në ERE me nr. 656/5, datë 19.5.2020, në të cilën, përveç sa deklaruar e argumentuar me herët, ka plotësuar me deklarime shtesë, të cilat në kuptim të parashikimeve të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, lidhen me shpjegime mbi vendimmarrjen e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 187, datë 25.11.2019, e janë përtej objektit të kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 22.4.2020.

- Provat në kuptim të parashikimeve të nenit 144, të "Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", duhet të jenë të tilla që të lidhen me zbulimin e rrethanave ose provave të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk diheshin dhe mund të diheshin prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.

- Në lidhje me lejen e shfrytëzimit të ujit, kërkuesi vlerëson faktin që nga ERE i është lënë një afat i papërcaktuar, por kërkon dorëzimin e dokumentit për një afat 6-mujor nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe të mos kushtëzohet operimi i HEC "Niçë" me këtë afat.

- Për sa i përket pretendimit të shoqërisë për të mos pasur asnjë kufizim për operimin përgjatë këtij afati të kërkuar, konstatojmë se për shkak të ndryshimit të projektit të zbatimit (evidentuar dhe në shkresën e AMBU-së) shoqëria nuk mundet të futet në operim pa disponuar lejen përfundimtare të dakordësuar/miratuar nga autoriteti përgjegjës, i cili lejon më tej shfrytëzimin e burimit ujor.

- Sa i përket autorizimit të ERE-s për të lejuar operimin e HEC "Niçë", me një fuqi të instaluar nën 1 mw, në kuptim të nenit 4.1.5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, kjo kërkesë nuk është objekt shqyrtimi nga ERE.

- Një shoqëri që operon në tregun e energjisë elektrike si prodhues i energjisë elektrike, me kapacitet të instaluar deri në 1 mw, nuk pajiset me licencë nga ERE, ndaj në të tilla kushte edhe kërkuesi mund të operojë në tregun e energjisë elektrike, nëse plotëson kriteret ligjore, teknike, administrative për të gëzuar këtë të drejtë, por jo në kushtet e disponimit të një licence nga ERE për të ushtruar aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet të instaluar 2270 kw, e cila si e tillë vendos për të licencuarin të drejta e detyrime të përcaktuara sipas vendimit të ERE-s dhe kushteve të licencës.

- Në kuptim të neneve 104, pika 4, si dhe 113, pika 3, të "Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", pika 1, germa "a", pika 2 dhe pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, **"Mbi licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë" me kapacitet të instaluar 2270 kw", janë në fuqi, deri sa të plotësohen kushtet dhe të shfuqizohen apo ndryshohen nga Enti Rregullator i Energjisë**.

- Kërkesa e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 74, datë 22.4.2020, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 187, datë 25.11.2019, 'Mbi licencimin e Shoqërisë 'MP—HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Niçë' me kapacitet të instaluar 2270 kw"', nuk plotëson kërkesat për rishikim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 22.4.2020, "*Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në*

veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Niçë', me kapacitet të instaluar 2270 kw'".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë(MIE) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 90, datë 22.5.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "*WENERG*" SHA, PËR BARRËSIM TË ASETEVE TË LUAJTSHME (MAKINERI DHE PAJISJE), NË FAVOR TË BANKËS "OTP ALBANIA" SHA, PËR EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË PËR FONDET E PËRDORURA, ME QËLLIM FINANCIMIN E NDËRTIMIT TË HEC "DARDHA 1"

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, pika 1 dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 6, nenit 7 dhe nenit 8, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit" të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, pikës 1.3 dhe 1.6 të "Licencës për prodhimin e energjisë elektrike", nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/7 prot., datë 17.2.2020 dhe relacionet shtesë të depozituara në datën 23.3.2020 dhe në datën 20.5.2020, të përgatitura nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "*Wenerg*" sh.a., për lënien barrë të aseteve në favor të bankës "OTP Albania" sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria "*Wenerg*" sh.a., regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me datë 18.9.2009 është licencuar nga ERE për ushtrimin e aktiviteteve të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria "*Wenerg*" sh.a., i është drejtuar ERE-s me shkresën e saj nr. HD1-5/20 prot., datë 31.1.2020, duke kërkuar miratim për lejimin e barrësimit të aseteve të luajtshme (makineri dhe pajisje) në favor të bankës "OTP Albania" sh.a., për ristrukturimin e kredisë, fonde të cilat shoqëria deklaron se do t'i përdorë për ndërtimin e hidrocentralit "Dardha 1".

Në këtë kërkesë, shoqëria ka bashkëlidhur dhe dokumentacionin për trajtimin e kësaj kërkese.

- Kërkesa e shoqërisë "*Wenerg*" sh.a., përcillet në ERE në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit" miratuar me vendimin nr. 119, datë 21.7.2016, të Bordit të ERE-s,

- Qëllimi i kësaj rregullore në zbatim të përcaktimeve të pikës 1 dhe pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, është përcaktimi i procedurës dhe dokumenteve të nevojshme për miratimin e kërkesave të të licencuarve për shitje, dhënie me qira, transferim, hipotekim, barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Në lidhje me kërkesën e shoqërisë për miratimin nga ERE të barrësimit të aktiveve të luajtshme (makineri + pajisje), rezulton se:

- aktivet e luajtshme i përkasin aktiveve afatgjata jo materiale ose jo fikse;

- makineritë dhe pajisjet i përkasin grupit të aktiveve afatgjata materiale ose fikse të cilat janë objekt trajtimi i "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit".

- Lista e aseteve, e cila është përcjellë në ERE bashkëlidhur kontratës në fjalë, nuk është e lexueshme dhe e aksesueshme, në mënyrë që të evidentohen asetet fikse të cilat i përkasin veprimtarisë së licencuar.

Subjekti koncesionar "*Wenerg*" sh.a., me kontratë koncesioni të formës BOT me nr. 6144

rep. dhe nr. 2021 kol., datë 18.8.2009, bazuar në deklarimet e bëra në pasqyrat financiare lidhur me pasqyrimin e aseteve, ka njohur asetet sipas modelit të aktivit jomaterial në zbatim të përcaktimeve të SNK 13 dhe SKK5, por mbështetur në KIRFN 12, subjekti koncesionar duhet të marrë paraprakisht autorizim prej koncensiondhënësit, (ish METE, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për lënien peng të aseteve, meqenëse kontrolli i koncesiondhënësit, mbi çdo interes të mbetur të konsiderueshëm, do të kufizonte aftësinë praktike të operatorit (subjekti koncesionar) për të shitur ose dhënë peng infrastrukturën.

- Shoqërisë "*Wenerg*" sh.a., me *e-mail*-in e datës 31.3.2020, iu dërgua një shkresë nëpërmjet së cilës iu kërkua saktësimi i objektit të kërkesës së saj, si dhe depozitimi në ERE në formë analitike, vetëm i listës së pajisjeve apo aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar për të cilat kërkohet barrësim, në përputhje me bilancet financiare të miratuara të shoqërisë.

- Meqenëse, bazuar në përcaktimet e germës "b", të nenit 4, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", përcaktohet se: Kërkohet miratimi i ERE-s për transferim të aseteve, kur vlera e asetit që kërkohet të transferohet është më e madhe se 150.000.000 lekë (njëqind e pesëdhjetë milion), dërgimi i informacioneve dhe shpjegimeve nga ana e shoqërisë do të mundësonte gjithashtu vlerësimin nëse kërkesa është në përputhje me parashikimet e rregullores së transferimit të aseteve.

- Rezulton se shoqëria "*Wenerg*" sh.a., nuk ka depozituar në ERE shpjegime apo informacion për sa kërkuar në shkresën e lartpërmendur, me qëllim saktësimin e objektit të kërkesës së saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "*Wenerg*" sh.a., për barrësim të aseteve në favor të bankës "OTP Albania" sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të HEC "Dardha 1".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 364 lekë